

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5833
E hënë, 22 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Specialja 'godet' skenën politike në Kosovë

IFAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ I FAQE 4 - 5



Zgjedhjet duhet të mbahen në fund të verës ose fillim të vjeshtës

Politologu Belul Beqaj ka thënë se, pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj, vendi është në udhëkryq. Ai ka treguar se paradoksalisht të gjithë janë për zgjedhje, ndonëse asnjë parti nuk është e përgatitur si dhe sa duhet për këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Beqaj ka vlerësuar se është koha për një rotacion të pushtetit, përndryshe thotë nuk mund të kenë kuptim zgjedhjet kur aktorët e njëjtë politikë vijnë sërish në pushtet. Ai ka thënë se zgjedhjet duhet të mbahen kur të shtjerrën rregullat kushtetuese, që i bie në fund të verës dhe fillim të vjeshtës. Sipas Beqajt, nëse zgjedhjet mbahen pa u kryer reformat zgjedhore, obligimet e dala nga procesi i dialogut dhe Kushtetuta, rezultati i tyre do t'i përngajë konfiguracionit aktual politik dhe gjendja e përgjithshme në Kosovë do të jetë e pashpresë

Fatmir Sejdiu pritet t'i hyjë garës për kryetar të LDK-së

Ish-lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fatmir Sejdiu, ka uruar të dielën për përfundimin e procesit zgjedhor në këtë parti dhe për zgjedhjen e kryetarëve të degëve dhe të nëndegëve. Ai ka bërë thirrje për unitet të brendshëm për Kuvendin e IX Zgjedhor të LDK-së që do të mbahet më 3 gusht, në të cilin do të zgjedhet lideri i ri i

saj. Sejdiu në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" nuk e konfirmon drejtpërdrejt nëse do t'i hyjë garës për kryetar të LDK-së, por lë mundësinë e hapur për kandidim. Burime të gazetës "Epoka e re", të afërta me Fatmir Sejdiun, kanë bërë me dije se ai do t'i hyjë garës për postin e të parit të LDK-së I FAQE 7



Në Rugovë të Pejës fillon kampi veror i diasporës

IFAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

JA PSE NUK KA MOBILIZIM NË MBROJTJE TË SHTETIT F. 11



Milazim KRASNIQI

AKTUALE



ZBULOHEK SHTATORJA E ATDHETARIT SHEJH MIHEDIN SHEHU F. 7

KIÇMARI: KOSOVA KURRË NUK KA PASUR MË PAK INTELEKTUALË NË KUVEND, QEVERTI DHE INSTITUCIONE SHTETËRORE F. 5

EKONOMI

DEPOZITAT E EKONOMIVE FAMILJARE DHE BIZNESEVE KAPIN SHIFRËN E 3.4 MILIARDË EUROVE F. 8

NË PUSHIME ME KREDI F. 9



SPORT

ELSHANI, BESNIK I DRENICËS F. 18

U19-SHET E MBYLLËN EVROPIANIN ME HUMBJE F. 18

Basha: Rama është kryeministri më hajdut në historinë e Shqipërisë

TIRANË, 21 KORRIK - Në takimin me demokratët e Lezhës, kreu i PD-së, Lulzim Basha, identifikoi Edi Ramën si problemin më të madh për ekonominë, papunësinë dhe shkatërrimin e drejtësisë. Basha iu referua skandalit të Gjykatës së Durrësit, e cila me kërkesën e dyshes Rama-Dako ndryshoi, në mënyrë të paprecedentë vendimin e saj të mëparshëm për pavlefshmërinë e mandatit të

prodhuar nga 30 qershori. "Kjo tregon se drejtësia është tërësisht e privatizuar nga Edi Rama. Tre vjet pas miratimit të reformës në drejtësi, drejtësia është tërësisht e kapur nga Rama. Kjo është arsyeja pse drejtësia nuk funksionon. Edi Rama është kryeministri më hajdut, më arrogant dhe më mashtrues në historinë e Shqipërisë. Paratë tuaja, paratë e shqiptarëve po i vjedh Edi Rama

me familjen dhe miqtë e tij. Pasurohen të pushtetshmit dhe të pasurit, varfërohen njerëzit e thjeshtë dhe të pambrojtur. Nëse shqiptarët nuk kanë të hanë është sepse paratë e tyre i ka vjedhur Edi Rama. Miliarda euro janë vjedhur, abuzuar dhe shpërdoruar këta 6 vjet, të gjitha kanë përfunduar në xhepat e Ramës dhe janë shpërdoruar për tekat e Ramës në luks dhe fasada", tha Basha.



Çfarë do të ofronin zgjedhjet e parakohshme në Maqedoninë e Veriut?

Kryeministri Zoran Zaev ka thënë se vendi nga zgjedhjet e reja do të humbiste ekonomikisht, ndërsa ka theksuar nevojën për të debatuar për çështjen që ka të bëjë me regjistrimin e popullsisë dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor



SHKUP, 21 KORRIK - Dyshimet për përfshirjen e ish-kryeprokurores speciale Katica Janeva në një skandal ryshfeti, kanë rritur kërkesat e opozitës për zgjedhje të parakohshme parlamentare. Pikërisht kjo kërkesë ka çuar në dështimin e takimit të liderëve të partive politike të thirrur nga kryeministri Zoran Zaev, për shkak se nuk ishte paraparë të debatohet për kërkesën e opozitës.

Zaevi ka thënë se vendi nga zgjedhjet e reja do të humbiste ekonomikisht, ndërsa ka theksuar nevojën për të debatuar për çështjen që ka të bëjë me regjistrimin e popullsisë dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Por, VMRO DPMNE-ja opozitare konsideron se "zgjedhjet janë zgjidhja e vetme për krizën e rëndë të nxitur nga qeveria e korruptuar dhe e paafte e kryeministrit Zaev".

Por, qëndrimet e tilla të partive politike nga njohësit e çështjeve politike, shihen edhe si taktizim për pozicione më të mira. "Mendoj se ajo që kërkon Mickovski më tepër ka të bëjë me presion ndaj pushtetit sesa

me mbajtjen e zgjedhjeve pasi dy partitë kanë besueshmëri thaujse të njëjtë dhe kjo do të ishte e rrezikshme për dy blloqet nëse vendosin të shkojnë në zgjedhje, në aspekt të numrit të deputetëve që mund të fitojnë dhe formimit më pas të qeverisë. Sidoqoftë, të gjitha partitë opozitare synojnë zgjedhjet për të ardhur në pushtet, kështu e shoh edhe kërkesën e opozitës te ne", thotë analisti Nenad Markoviq duke shtuar se zgjedhje këtë vit vështirë se do të ketë, por nuk e përjashton mundësinë që ato të mbahen në pranverë, por gjithçka sipas tij varet nga raporti i BE-së, në vjeshtë, sa i përket datës për çeljen ose jo të negociatave. "Mendoj se zgjedhje nuk do të ketë këtë vit para se gjithash për shkak të pritjeve të vendimit të BE-së në tetor, për çeljen ose jo të negociatave me Maqedoninë e Veriut. Vendimi që do të merret konsideroj se do të përcakttojë kursin e ardhshëm të partive politike. Nëse merret data, besoj se zgjedhjet e parakohshme janë më reale dhe ato do të mund të mbaheshin

në mars apo prill të vitit të ardhshëm. Ky do të ishte momenti më i volitshëm për pushtetin që datën ta shfrytëzojë për ruajtjen e pushtetit në zgjedhje. Pra, gjërat do të jenë më të qarta në tetor dhe deri atëherë do të vazhdojnë përplasjet mes partive për pozicione më të fuqishme", thotë Markoviq.

Por, ndryshe nga ai mendon Arsim Sinani nga Qendra për Studime Ndërkombëtare dhe Hulumtime Ballkanike, sipas të cilit, vendi ka nevojë për zgjedhje të reja. "Mendoj se Maqedonisë së Veriut i duhen zgjedhje të parakohshme parlamentare për shkak se na duhet

një qeveri me më tepër kompetenca dhe më pak e korruptuar dhe nuk mendoj se kjo përbërje maqedonase mund të sjellë diçka të mirë për qytetarët, përveç pesimizmit dhe largimit të tyre për shumë arsye të cilat dihen", thotë Sinani, duke akuzuar qeverinë për mospërbushjen e premtimeve të shumta që kishte dhënë para ardhjes në pushtet dy vjet më parë, e të cilat edhe mund të jenë arsye që Zaevi t'i shmanget mbajtjes së zgjedhjeve. "Qeveria aktuale është në krizë të thellë për shkak se nuk kemi parë reforma gjatë kësaj periudhe. Çështja tjetër është se Zaevi është në pikën më të ulët për shumë arsyeje për

shkak se abuzoi me votën e qytetarit. Ndërkohë kur flas për shqiptarët në raport me qeverinë, ata nuk panë diçka substanciale për ta, por vetëm premtime dhe buzëqeshje. Pra, këto janë pak a shumë shqetësimet se pse nuk do të mbahen zgjedhje", thotë Sinani. Mundësia për zgjedhje të parakohshme ishte paralajmëruar fillimisht nga kryeministri Zoran Zaev në rast të mosmarrjes këtë verë të datës për negociatave me BE-së, por në vend të kësaj, Zaevi ka bërë një riformatim të vogël të qeverisë, që nga opozita është vlerësuar më tepër si farsë për t'iu ikur zgjedhjeve të parakohshme.

Gjendet i vrarë presidenti i vetëshpallur i Çamërisë

PRISHTINË, 21 KORRIK - Miq dhe bashkëkombës të shumë shpërndanë mesazhe në rrjetet sociale, duke thënë se në Holandë është vrarë në një atentat Festim Lato. Disa orë pas reagimeve, mediet holandeze shkruajnë se Lato dyshohet se është personi që është gjetur të dielën i vrarë në Holandë.

Mediet e Holandës shkruajnë se të

dielën në mëngjes është gjetur i vrarë në Nijmegen shtetasi Festim Lato. Shqiptari kishte borxhe të shumta dhe kjo mendohet se është edhe arsyeja e vrasjes apo vetëvrasjes së tij. Policia tha më herët se kishte marrë një njoftim. Familjarët e tij kishin thënë se i afërmi nuk po bëhej i gjallë që një javë.

Trupi i tij i pajetë është gjetur në një

rugë në Nijmegen të shtunën pasdite. Policia ende po e heton rastin. Në vitet e fundit, Lato ka qëndruar në një shtëpi të largët në Afferden, në Betuwe. Në këtë shtëpi valëviten flamuri i Çamërisë, i Holandës dhe i ShBA-së. Çamëria është një rajon mes Shqipërisë dhe Greqisë, që dëshiron pavarësinë. Lato e kishte shpallur veten president të rajonit të Çamërisë.



Gjykata Speciale ka vazhduar dërgimin e ftesave për intervistim ndaj ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

Specialja 'godet' skenën politike në Kosovë

Gjykata Speciale javën e kaluar ka trazuar skenën politike me dërgimin e ftesave për intervistim të ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Përveç Ramush Haradinajt, ftesë për t'u intervistuar nga Specialja ka marrë edhe ish-zëdhënësi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Jakup Krasniqi, ish-shefi i këtij shtabi, Bislim Zyrtari, dhe ish-anëtari i Shtabit të UÇK-së, Sokol Bashota. Ata kanë pranuar t'i përgjigjen kësaj gjykate, duke premtuar se do ta mbrojnë pastërtinë e luftës së UÇK-së. Deri më tani dhjetëra ish-pjesëtarë të UÇK-së kanë marrë ftesa për intervistim qoftë në cilësinë e të dyshuarit, qoftë të dëshmitarit

së drejtë e të pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkundër qëndrimit tim të hapur kritik e kundërshtues për krijimin me presion të kësaj gjykate, unë do të prezantohem në hetuesinë e saj në datën e caktuar në cilëndo cilësi. Me besim në drejtësinë, i bindur se e vërteta është që gjatë luftës në Kosovë, Serbia ka kryer gjenocid, kurse konstruktet e saj monstruoze për UÇK-në do të bien poshtë, unë do të jem atje për ta dhënë kontributin tim për ndriçimin e së vërtetës historike", ka deklaruar ai, duke shtuar se në vend se Serbia të ballafaqohet me drejtësi për krimet e luftës, po ballafaqohet Kosova me akuzat të trilluara. "Megjithatë, është fatkeqësi dhe ironi e llojit të vet, që në vend se Serbia të përballet me drejtësinë për krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidit, ne duhet të mbrohemi nga akuzat e saj të trilluara; në vend se të

gjykojnë argumentet dhe provat e pamohueshme dhe të njohura botërisht, drejtësia merret me trille dhe shpifje të ulëta të politikës serbe dhe të shërbimeve të saj sekrete. Përkundër bindjeve të mia sa i përket kësaj gjykate politike, të krijuar me presion politik nga njerëzit që bartin funksione të larta shtetërore në Kosovë dhe themelimin e saj me votën e atyre deputetëve që ishin numra në Kuvendin e Kosovës, unë do të prezantohem në hetuesinë e Gjykatës Speciale", është shprehur Krasniqi. Ai ka rikujtuar se kjo nuk do të jetë hera e parë që del para hetuesve për të dhënë përgjigje për çështje të sajura nga pushteti i Serbisë. "Ja kam dalë në proceset e hetuesisë jugosllave të viteve tetëdhjetë, siç ia kam dalë me përgjegjësi edhe kur jam ftuar nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi, për rastet e kur-

disura në bazë të dosjeve të dorëzuara nga Serbia kundër Fatmir Limajt, Ramush Haradinajt dhe bashkëluftëtarëve të tyre. Në të dy rastet kam dhënë deklarata në cilësinë e zëdhënësit të UÇK-së, përfaqësuesit të saj politik dhe anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së gjatë luftës së viteve 1998-1999. Deklaratat e mia në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi janë publike, siç është publik edhe verdikti i kësaj gjykate kur i hodhi si të pabaza të gjitha akuzat kundër Fatmir Limajt dhe Ramush Haradinajt, duke shpallur pafajësinë e tyre. As kësaj radhe nuk mund të jetë ndryshe", ka thënë Krasniqi.

Të ftuar nga Gjykata Speciale janë edhe dhjetëra ish-drejtues të UÇK-së, përfshirë këtu Sami Lushtakun, Rrustem Mustafën, Sylejman Selimin, Shukri Bujën dhe figura të tjera.

**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 21 KORRIK - Në javën e kaluar Gjykata Speciale ka ftuar për intervistim figura të rëndësishme të skenës politike në Kosovë. Në mesin e tyre është edhe Ramush Haradinaj, i cili ka dhënë dorëheqje nga posti i kryeministrit pikërisht për shkak të ftesës nga Specialja në cilësinë e të dyshuarit.

Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se në Hagë do të dalë përballë shpifësve ashtu si e kërkon nderi i luftëtarit shqiptar. Ai ka thënë se pastërtia e tij dhe lufta e UÇK-së nuk mund të njolloset nga askush dhe asnjëherë. "Qeveritë dhe pushtetet janë të ndërrueshme, jetojmë në demokraci. Nderi i kryeministrit dhe shtetit duhet të ruhet dhe unë nuk e poshtëroj asnjëherë. Në Hagë si Ramush Haradinaj do t'u dal përballë shpifësve ashtu si e kërkon nderi i luftëtarit shqiptar. Pastërtia ime dhe e luftës së UÇK-së, e konfirmuar nga dy aktgjykime, nuk mund të njolloset nga askush dhe asnjëherë", ka theksuar Haradinaj.

Ftesë nga Gjykata Speciale ka marrë edhe ish-zëdhënësi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Jakup Krasniqi, i cili ka bërë me dije se më 24 korrik do të paraqitet në Hagë. Krasniqi ka thënë se do të shkojë në Hagë për ta dhënë kontributin

për ndriçimin e së vërtetës historike. "Pavarësisht prej bindjeve të mia që Gjykata Speciale, e ngritur mbi bazën e raportit të Dick Martit, miratuar nga Këshilli i Evropës, i cili fund e krye është sajuar në Beograd me shpifje e gënjeshtër dhe me motiv e qëllim të komprometit dhe inkriminimit të luftës



Në Rugovë të Pejës fillon kampi veror i diasporës

PEJË, 21 KORRIK (ER) - Në kuadër të organizimit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS) për "Ditët e Diasporës", të shtunën në Rugovë të Pejës ka nisur kampi diaspora. Më shumë se 30 fëmijë nga vende

të ndryshme të Evropës po marrin pjesë në këtë kamp, i cili ka për qëllim kryesor krijimin dhe forcimin e lidhjes mes fëmijëve dhe vendlindjes së tyre.

Përmes aktiviteteve dhe lojërave të shumta që organizohen në kamp,

synohet ruajtja e traditës, kulturës dhe gjuhës shqipe. Fëmijët do të arrijnë të krijojnë lidhje shoqërore edhe me fëmijët nga Kosova, duke forcuar kështu dashurinë për vendlindjen. Kampi diaspora do të zgjasë deri më 24 korrik.



Flet për "Epokën e re", Belul Beqaj

Zgjedhjet duhet të mbahen në fund



Politologu Belul Beqaj ka thënë se, pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj, vendi është në udhëkryq. Ai ka treguar se paradoksalisht të gjithë janë për zgjedhje, ndonëse asnjë parti nuk është e përgatitur si dhe sa duhet për këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Beqaj ka vlerësuar se është koha për një rotacion të pushtetit, përndryshe thotë nuk mund të kenë kuptim zgjedhjet kur aktorët e njëjtë politikë vijnë sërish në pushtet. Ai ka thënë se zgjedhjet duhet të mbahen kur të shtjerën rregullat kushtetuese, që i bie në fund të verës dhe fillim të vjeshtës. Sipas Beqajt, nëse zgjedhjet mbahen pa u kryer reformat zgjedhore, obligimet e dala nga procesi i dialogut dhe Kushtetuta, rezultati i tyre do t'i përngjajë konfiguracionit aktual politik dhe gjendja e përgjithshme në Kosovë do të jetë e pashpresë

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 21 KORRIK - Politologu Belul Beqaj ka thënë të dielën se tashmë ka ardhur koha për një rotacion të pushtetit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", ai ka thënë se duhet krijuar një qeveri kalimtare e cila do t'i përfundonte disa procese të rëndësishme. "Personalisht mendoj se pas gati njëzet vjetëve duhet bërë rotacion të pushtetit. Duke krijuar një qeveri kalimtare e cila do të bënte reforma zgjed-

hore, ndryshimin e Kushtetutës, mund t'i kryente edhe obligimet e papërbushura nga procesi i dialogut me Serbinë", është shprehur Beqaj, duke shtuar se vendi gjendet në udhëkryq. "Kosova është në udhëkryq. Qeveria ishte në udhëkryq,

kryeministri ka pasur dy rrugë: të vazhdojë si aventurier drejt greminës apo të manovrojë me shpresë se do t'i shpëtojë greminës. Gjykata Speciale ndërkombëtare do ta humbë kredibilitetin nëse edhe për të tretën herë Ramush Haradinaj lirohet nga Haga po u ngritur aktakuza. Ndërsa do të humbë kuptimin nëse ngritet aktakuza më shumë në sajë të argumenteve politike sesa juridike", ka deklaruar ai. Pas zhvillimeve të fundit, sipas Beqajt, vendi do të shkojë në zgjedhje dhe procesi zgjedhor do të mbahet në fund të verës ose në fillim të vjeshtës. "Zgjedhjet duhen mbajtur kur të shtjerën rregullat kushtetuese, që i bie në fund të verës dhe fillim të vjeshtës. Ky insistim për zgjedhje është dëshmi se sa janë të paepur për pushtet dhe sa janë të

painteresuar për ta ndryshuar politikëbërjen kleptokratike", ka theksuar ai. Pavarësisht prej insistimit për zgjedhje të parakohshme, Beqaj ka thënë se asnjë prej subjekteve politike nuk janë të përgatitura për proces zgjedhor. "Paradoksalisht të gjithë janë për zgjedhje, ndonëse asnjë parti nuk është e përgatitur si dhe sa duhet për zgjedhje. Është koha fundit që ato të reflektojnë seriozisht duke pasur një vizion të shëndoshë politik, e jo vetëm pushtetin. Zgjedhjet e deritanishme kanë lëshuar nga sita me shumë 'egjër sesa grurë' në pushtetbërje! Kjo gjendje duhet ndryshuar, përndryshe ç'kuptim kanë zgjedhjet kur aktorët e njëjtë të qasjes së njëjtë politike vijnë sërish në pushtet, pavarësisht çfarë roli mund të luajë Vetëvendosja në këtë konstela-

d të verës ose fillim të vjeshtës

kryeministri ka pasur dy rrugë: të vazhdojë si aventurier drejt greminës apo të manovrojë me shpresë se do t'i shpëtojë greminës. Gjykata Speciale ndërkombëtare do të humbë kredibilitetin nëse edhe për të tretën herë Ramush Haradinaj lirohet nga Haga po u ngritur aktakuza. Ndërsa do të humbë kuptimin nëse ngritët aktakuza më shumë në saje të argumenteve politike sesa juridike.

"Epoka e re": Pas këtyre zhvillimeve vendi do të shkojë në zgjedhje të parakohshme apo do të gjendet një formulë për të vazhduar tutje?

Beqaj: Paradoksalisht të gjithë janë për zgjedhje, ndonëse asnjë parti nuk është e përgatitur si dhe sa duhet për zgjedhje. Është koha e fundit që ato të reflektojnë seriozisht duke pasur një vizion të shëndoshë politik, e jo vetëm pushtetin. Personalisht mendoj se pas gati njëzet vjetëve duhet bërë rotacion të pushtetit. Duke krijuar një qeveri kalimtare e cila do të bënte reforma zgjedhore, ndryshimin e Kushtetutës, mund t'i kryente edhe obligimet e papërbushura nga procesi i dialogut me Serbinë. Ndërkohë Gjykata Speciale ndërkombëtare do ta qartëson pozitën juridike të personave që po i fton, ndërsa qytetarët do ta kishin më të qartë situatën se për kë dhe pse duhet votuar. Zgjedhjet e deritanishme kanë lëshuar nga sita me shumë 'egjër sesa grurë' në pushtetbërje! Kjo gjendje duhet ndryshuar, përndryshe ç'kuptim kanë zgjedhjet kur aktorët e njëjtë të qasjes së njëjtë politike vijjnë sërish në pushtet, pavarësisht se çfarë roli mund të luajë Vetëvendosja në këtë konstelacion. Qytetarët janë për qeverisje të mirë e jo për të mbështetur ata që e kanë sjellë Kosovën në udhëkryq.

"Epoka e re": Partitë kryesore në vend janë shprehur pro mbajtjes së zgjedhjeve të reja. Në rast se do të ketë zgjedhje, kur mendoni se duhet të mbahen ato?

Beqaj: Zgjedhjet duhen mbajtur kur të shtjerrën rregullat kushtetuese, që i bie në fund të verës dhe fillim të vjeshtës. Ky insistim për zgjedhje është dëshmi se sa janë të paepur për pushtet dhe sa janë të paineduar për ta ndryshuar politikbërjen kleptokratike.

"Epoka e re": Vetëvendosja i ka bërë thirrje presidentit të mos e zvarrisë proceduralisht procesin drejt zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Mendoni se mund të zvarritet ky proces?

Beqaj: Vetëvendosja, sikur edhe partitë e tjera, për shkaqe të tjera nuk është e përgatitur për zgjedhje. Prej kryetarit të

Vetëvendosjes kam pritur zgjuarsi për konsolidim të mëtejshëm organizativ, kadrovik dhe vizion të qartë pushtetbërës e jo të sprintojë pas partive kleptokratike të cilat e kanë degraduar Kosovën. Vetëvendosje është më mirë të vendosë

standarde se të jetë pjesë e pushtetit kleptokratik.

"Epoka e re": Si e shihni mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme dhe a prisni ndryshime pas këtij procesi zgjedhor?

Beqaj: Nëse mbahen zgjedhjet

pa u kryer reforma zgjedhore, obligimet e dala nga procesi i dialogut dhe Kushtetuta, rezultati i zgjedhjeve do t'i përngjajë konfiguracionit aktual politik, por gjendja e përgjithshme në Kosovë do të jetë e pashpresë.

Kiçmari: Kosova kurrë nuk ka pasur më pak intelektualë në Kuvend, qeveri dhe institucione shtetërore

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 KORRIK - Ish-ambasadori i Kosovës në Austri dhe Australi, Sabri Kiçmari, ka thënë se nevoja për shndërrime rrënjësore në shoqërinë dhe shtetin tonë është bërë domosdoshmëri. Ai ka thënë se ndryshimin në vend mund ta bëjnë katër shtresa kryesore të shoqërisë: intelektualët, luftëtarët e dinjitetshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të rinjtë dhe mërgimtarët.

Kiçmari ka theksuar se Kosova kurrë nuk ka pasur më pak intelektualë në kuvend, qeveri dhe institucione shtetërore. "Ndryshimin mund ta bëjnë

katër shtresa kryesore të shoqërisë së Kosovës: intelektualët, luftëtarët e dinjitetshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të rinjtë dhe mërgimtarët. Kosova kurrë nuk ka pasur më pak intelektualë në kuvend, qeveri dhe institucione shtetërore. Atyre duhet krijuar hapësirë dhe mundësi. Dija e tyre është jetike për zhvillimin e vendit. Ushtarët e UÇK-së, që kanë ruajtur me krenari dinjitetin e luftëtarit të lirisë, janë shumicë absolute. Koha e sotme i kërkon ata të rikthehen në skenën shoqërore, për të ndaluar këtë mësymje tragjike profiterësh drejt vlerave shoqërore dhe shtetërore. Të rinjtë e vendit tonë duhet të

marrin pjesë në ridimensionimin e së ardhmes së vendit tonë këtu, në atdhe. Atyre duhet krijuar hapësira e nevojshme për t'i shpërthyer energjitë e tyre kreative", ka thënë Kiçmari.

Ai ka shtuar se mërgimtarët janë shtresa që mbartë në vete mallin dhe dhembjen, heroizmin dhe profesionalizmin. "Ata e ëndërrojnë Kosovën të përparuar dhe ideale. Prandaj, duhet krijuar hapësirë e nevojshme për ekspertizën dhe vullnetin patriotik të tyre. Kosova ka potenciale të shumta për t'u bërë shtet i përparuar. Mjafton hapja e mundësive për njerëzit e mirë të vendit tonë", ka deklaruar ish-ambasadori Kiçmari.



cion. Qytetarët janë për qeverisje të mirë, jo për t'i mbështetur ata që e kanë sjellë Kosovën në udhëkryq", ka thënë Beqaj, duke shtuar se rezultati i zgjedhjeve të parakohshme do t'i përngjajë konfiguracionit aktual politik. "Nëse mbahen zgjedhjet pa u kryer reforma zgjedhore, obligimet e dala nga procesi i dialogut dhe Kushtetuta, rezultati i zgjedhjeve do t'i përngjajë konfiguracionit aktual politik, por gjendja e përgjithshme në Kosovë do të jetë pa shpresë", ka theksuar ai.

"Epoka e re": Z. Beqaj, si e komentoni dorëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinajt pas marrjes së ftesës për intervistim nga Gjykata Speciale në cilësinë e të dyshuarit?

Beqaj: Kosova është në udhëkryq. Qeveria ishte në udhëkryq,

Hapet pika kufitare Restelicë - Strezomir

RESTELICË, 20 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të shtunën mori pjesë në ceremoninë e hapjes zyrtare të pikës së përkohshme kufitare Restelicë - Strezomir. Ministri Lekaj ka rikonfirmuar zotimin e tij dhe dikasterit që ai drejton për ta përfunduar infrastrukturën

rrugore edhe për pesë kilometrat e mbetura deri në pikën kufitare që u përfundua. Pika kufitare Restelicë - Strezomir fillimisht do të jetë e hapur vetëm në sezon, nga 20 korriku deri më 20 gusht, ndërsa në të ardhmen pritet të bëhet pikë kalimi e përhershme.



Vdes një person në kryeqytet pas lëndimeve që mori nga një përleshje

PRISHTINË, 21 KORRIK (ER) - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka njoftuar se të shtunën ka vdekur personi me inicialet G.R. si pasojë e lëndimeve të rënda që i ka marrë nga një përleshje të nënkalimi i rrugës "Bill Clinton" në Prishtinë. Prokuroria e Prishtinës njofton se deri më tani nuk dihen motivet e kësaj rrah-

je si dhe sulmuesi ende është në arrati. Po ashtu, Prokuroria ka siguruar të gjitha provat nga vendi i ngjarjes. Trupi i personit të pajetë është në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe pritet të dërgohet në Institutin e Mjekësisë Ligjore për autopsi.

Përmbyllen dëgjimet buxhetore në fshatrat dhe zonat urbane të Ferizajt

FERIZAJ, 21 KORRIK (ER) - Në ditën e fundit të dëgjimeve buxhetore me qytetarë për hartimin e buxhetit të vitit 2020 dhe planifikimet buxhetore 2021-2022, kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, i shoqëruar edhe nga drejtori i Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, ai i Arsimit, Afrim Llabjani, në shkollën e fshatit Surqinë ka takuar banorët e fshatrave Surqinë, Cërnillë, Prelez i Muhaxherëve, Mirash, Tërrn, Luboc dhe Bablak, kurse në ndalesën e dytë ka takuar banorët e fshatrave Muhoc, Prelez i Jerlive, Saraishtë dhe Talinoc i Jerlive. Me këtë rast, Aliu u ka bërë me dije të pranishmëve mundësitë buxhetore të Komunës së Ferizajt për t'i përfshirë kërkesat e banorëve në investime, duke theksuar se



nga 9 milionë euro sa është vlera e fondit e investimeve

kapitale, vetëm tre prej tyre mund të përdoren për plani-

fikimet e reja për shkak se vlera e 6 milionë eurove është

detyrim kontraktual. Në anën tjetër, banorët e këtyre fshatrave kanë parashtruar kryesisht kërkesa dhe shqetësime të njëjta. Fokusi i kërkesave të tyre kishte të bënte me rregullimin e infrastrukturës rrugore dhe asaj nëntokësore, krijimin e hapësirave të reja rekreative-sportive, mirëmbajtjen e hapësirave publike si dhe investimet në objekte shkollore dhe anekse të tjera. Kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, duke u dhënë përgjigje kërkesave të banorëve, ka thënë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara për t'i absorbuar të gjitha kërkesat e parashtruara, por ka theksuar se do të hyjnë në planifikimet buxhetore projektet që kanë nevojë të menjëhershme për ndërhyrje.

Kopiliqi i Skenderajt bëhet edhe me dy rrugë të reja

SKENDERAJ, 21 KORRIK (ER) - Ka filluar implementimi i projektit të ri rrugor në fshatin Kopiliqi, i cili parashihet asfaltimin e dy segmenteve rrugore, përkatësisht rrugën në lagjen "Havolli" dhe në atë "Pavarësia". Me këtë rast, fillimin e punimeve e kanë inspektuar nënkryetari i Skenderajt, Nuredin Lushtaku, së bashku me drejtoreshën për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Sanije Ahmeti, inxhinierët dhe profesionistët e

kësaj komune. Ndërsa kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se është i kënaqur me vlerësimet pozitive të banorëve vendës për punën e tij. "Nëpërmjet këtij projekti, që vjen si rezultat i kërkesave të kamotshme të banorëve të fshatit, e që komuna jonë po u përgjigjet pozitivisht, do të asfaltohen rreth 3 500 metra rrugë lokale brenda lagjeve, përkatësisht rrugët 'Havolli' dhe 'Pavarësia'. Jemi të kënaqur me

vlerësimet pozitive të deklaruara nga vetë banorët e fshatit që kanë dhënë kontribut të madh në luftë, por pa mundur deri tani t'i shijojnë përfitimet e buxhetit komunal", ka deklaruar kryetari Jashari. Edhe banorët e fshatit në fjalë e kanë mirëpritur nisjen e punimeve, duke e vlerësuar lart punën dhe angazhimin e kryetarit Jashari dhe ekzekutivit për këto projekte të rëndësishme për qytetarët e Skenderajt.



Më 3 gusht Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) do ta mbajë Kuvendin e IX Zgjedhor, në të cilin do të zgjedhet lideri i ri i saj

Fatmir Sejdiu pritët t'i hyjë garës për kryetar të LDK-së

Ish-lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fatmir Sejdiu, ka uruar të dielën për përfundimin e procesit zgjedhor në këtë parti dhe për zgjedhjen e kryetarëve të degëve dhe nën-degëve. Ai ka bërë thirrje për unitet të brendshëm për Kuvendin e IX Zgjedhor të LDK-së që do të mbahet më 3 gusht, në të cilin do të zgjedhet lideri i ri i saj. Sejdiu në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" nuk e konfirmon drejtpërdrejt nëse do t'i hyjë garës për kryetar të LDK-së, por lë mundësinë e hapur për kandidim. Burime të gazetës "Epoka e re", të afërta me Fatmir Sejdiun, kanë bërë me dije se ai do t'i hyjë garës për postin e të parit të LDK-së



siç ka thënë ai, "duke kurorëzuar me sukses procesin zgjedhor, kështu do të shkruajmë bashkërisht edhe një faqe të re të historisë sonë, që do të jetë shenjë se LDK-ja është partia më e besuar dhe më e organizuar në Kosovë".

Sejdiu ka thënë se LDK-ja me udhëheqjen e re do të jetë e gatshme që ta marrë përsipër drejtimin e qeverisjes në vend. "Me vizion të qartë dhe me lidhshmëri të zgjedhur në Kuvendin e ardhshëm që do të jetë përfaqësues i identitetit të një partie me vlera të dëshmuara politike, nacionale, humane dhe qytetare; si një forcë politike e përgjegjshme para interesave të qytetarëve të Kosovës, LDK-ja do të jetë e gatshme ta marrë përsipër drejtimin dhe qeverisjen e vendit në mandatin e ardhshëm që do të dalë nga zgjedhjet nacionale para nesh", ka thënë Sejdiu.

Lideri aktual i LDK-së, Isa Mustafa, deri më tani ende nuk është deklaruar nëse do të kandidojë sërish për postin e kryetarit. Ai ka thënë se qëndrimin e tij do ta bëjë publik pas përfundimit të procesit zgjedhor të LDK-së. Kohët e fundit emra të mundshëm për kryetar të LDK-së janë përmendur Lutfi Haziri, Agim Veliu, Kujtim Shala dhe Vjosa Osmani. Ish-kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka shprehur gatishmërinë për ta marrë drejtimin e LDK-së, por ka thënë se fillimisht do të pëlqente që të arrihej një marrëveshje e brendshme, që synim ka bashkimin e kësaj partie.

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 21 KORRIK - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) më 3 gusht do të mbajë Kuvendin Zgjedhor, në të cilin do të zgjedhet kryetari i ri i kësaj partie. Më 3 gusht kandidaturën për kryetar të LDK-së pritët paraqesë edhe Fatmir Sejdiu. Burime të gazetës "Epoka e re", të afërta me Fatmir Sejdiun, kanë konfirmuar se Sejdiu do t'i hyjë garës për postin e të parit të LDK-së. "Deri më tani disponimi është edhe nga ana e z. Fatmir Sejdiu, një pjese të udhëheqjes aktuale dhe të një pjese të madhe të degëve, që z. Sejdiu ta paraqesë kandidaturën për kryetar. Të shohim, kemi edhe disa ditë deri te Kuvendi Zgjedhor i LDK-së", ka thënë ky burim për gazetën "Epoka e re".

Gazeta ka bërë përpjekje për të marrë edhe një qëndrim të Fatmir Sejdiut të dielën, por ai nuk e ka hapur telefonin. Por të dielën, përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook", Sejdiu ka folur për Kuvendin Zgjedhor të kësaj partie që do të mbahet më 3 gusht, në të cilin do të zgjedhet kryetari i ri i saj. Sejdiu në këtë shkrim nuk e konfirmon drejtpërdrejt nëse do t'i hyjë garës për kryetar të LDK-së, por lë mundësinë e hapur për kandidim. Ai ka bërë thirrje për unitet të brendshëm partiak, duke theksuar se LDK-ja është shtëpi të cilën e ndërtoan bashkërisht dhe duhet mbajtur të fortë.

Sejdiu ka thënë se Kuvend i IX Zgjedhor i LDK-së duhet të jetë kuvend i pasurimit dhe ringritjes së parimeve fundamentale mbi të cilat është themeluar dhe është ngritur LDK-ja: liria, toler-

anca, konkurrenca, përgjegjësia dhe transparenca. "Këto parime i dhanë identitetin fisnik, politik dhe qytetëruës popullit dhe vendit tonë të dashur, Republikës së Kosovës, që ka për embleme filozofinë e presidentit historik të pavarësisë dhe shtetit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, që u bë edhe shenjë respekti për Kosovën kudo në botë. Në Kuvendin e ardhshëm të Lidhjes Demokratike të Kosovës ne duhet të gjithë bashkë, me unitet veprimesh si një forcë politike prijëse, të mobilizohemi edhe një herë për ta realizuar plotësisht vizionin e Kosovës shtet i pavarur, sovran dhe demokratik. Për ta bërë Kosovën një vend normal dhe me perspektivë të qartë të zhvillimit, në të cilin të gjithë duam të jetojmë. Një Kosovë në të cilën sundon rendi dhe ligji dhe që përparon shpejt në procesin e

integritimit euroatlantik në BE dhe në NATO dhe që mban fuqishëm bashkëpunimin e miqësinë e përhershme me ShBA-në", ka thënë ish-lideri i LDK-së.

Ai ka theksuar se Kosova është duke kaluar në një fazë kritike tash e sa vjet. "Prandaj, Lidhja Demokratike e Kosovës, si parti e vizionit të qartë dhe e veprimeve të qëndrueshme e të guximshme, i duhet më shumë se kurrë në udhëheqje vendit tonë. Kosovës i duhet lidhshmëria e LDK-së i vendosur në mbrojtje dhe ruajtje të sovranitetit shtetëror dhe të integritetit territorial të Kosovës, që është vënë në shënjestër nga veprimet e Serbisë të kamufluara në pakon e dialogut me Kosovën", është shprehur Sejdiu. Ai ka thënë se është momenti që në Kuvendin e ardhshëm zgjedhor të LDK-së të dëshmohej vlerat demokratike,

Zbulohet shtatorja e atdhetarit Shejh Mihedin Shehu

RAHOVEC, 21 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të dielën në akademinë përkujtimore dhe në zbulimin e shtatorës së atdhetarit Shejh Mihedin Shehu, në 21-vjetorin e rënies së tij, organizuar nën përkujdesjen e Zyrës së Kryeministrit. Fillimisht kryeministri Haradinaj ka bërë homazhe te pllaka përkujtimore e Shejh Mihedin Shehut, në hyrje të Teqesë së Madhe.



Kryeministri Haradinaj ka thënë se një ngjarje si kjo i bën krenarë popujt, sepse sot janë në vendin ku 21 vjet më parë ra heroikisht një udhëheqës fetar e shpirtëror dhe, përveç petkut fetar dhe shpirtëror, në vete kishte brumin e atdhetarit të shquar shqiptarë, të rilindësit,

por edhe të atyre që nuk u ndalën në kohë.

Haradinaj ka kujtuar periudhën e pas vitit 1945, kur shumë atdhetarë, luftëtarë të zotë, e gjetën vetën në periudha të vështira se si të vazhdohet më tutje në shërbim të atdheut dhe të kom-

bit. "Janë vetëm pak njerëz të kombit tonë që nuk u ndalën, është një brez i vogël i tyre dhe nuk është rastësi që në këta njerëz e gjejmë Shejh Mihedinin, i gjejmë shehlerët e tjerë, ata që u dënuan në grup. Kjo për shkak se vetëdija e

ngritur, devotshmëria, besimi i bëri që të mos dorëzohen, të mos bëjnë kompromis", ka thënë kryeministri Haradinaj. Më tej, kryeministri Haradinaj ka thënë se Shejh Mihedin është pjesë e atdhetarëve, e luftëtarëve, dijetarëve, që historianët do të kenë punë me të, për shkak se kur vlerësojnë pozicionimin, angazhimin e tij të asaj kohe dhe rrugën e tij nëpër këto etapa, secila etapë në vete do të jetë kapitull i rëndësishëm i angazhimit për popull, për liri, për atdhe, për të qenë i liri në besim, në identitet.

Haradinaj ka thënë se nuk është rastësi se pse Shejh Mihedinin nuk e përfillim urdhrin e forcave serbe, të regjimit të Millosheviqit, që të vihet në

anën e tyre për ta bindur popullin që të mos rezistojë, për ta larguar popullin nga UÇK-ja, për ta bindur UÇK-në që t'i ndalë operacionet e tyre luftarake, detyrat e tyre për liri, pra ai nuk e pranojë një rol të tillë, ai mbeti në rolin e vet që kishte, besnik ndaj besimtarëve të vet, besnik ndaj popullit, ndaj atyre që ishte dhe ndau fatin me ta në Teqenë e Madhe në Rahovec.

Kryeministri Haradinaj me këtë rast pasuesit të Teqesë, Shejh Besimit, i ka dhënë medaljen "Gjergj Kastrioti Skënderbeu". Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se Shejh Mihedin Shehu do të kujtohet gjithmonë si udhëheqës shpirtëror e fetar, si patriot dhe hero i Kosovës.

Depozitat e ekonomive familjare dhe bizneseve kapin shifrën e 3.4 miliardë eurove

Depozitat e klientëve të bankave komerciale deri më 31 maj të këtij viti kanë qenë 3.4 miliardë euro, prej të cilëve depozita të ekonomive familjare kanë qenë 2.4 miliardë euro. Kurse vlera e kredive deri në maj të këtij viti për ekonomitë familjare është 1.04 miliard euro, ndërkaq për korporatat jofinanciare 1.85 miliard euro. Sipas anëtarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Lutfi Zharku, dhe drejtorit të "D&D Business Support Center", Safet Fazliu, niveli prej 3.4 miliardë eurosh i depozitave tregon për klimën e biznesit në Kosovë, respektivisht guximin për të investuar dhe multiplifikuar paratë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 KORRIK - Në pesëmujorin e këtij viti vlera e depozitave të qytetarëve të Kosovës në bankat komerciale kap vlerën e 3.4 miliardë eurosh. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kjo shumë ka shënuar rritje. Pas rritjes së depozitave, rritje ka shënuar edhe niveli i kredive si për ekonomitë familjare ashtu dhe spektrin biznesor.

Zëdhënësi i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Kushtrim Ahmeti, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se niveli i depozitave dhe kredive ka shënuar rritje në pesëmujorin e parë të këtij viti karshi vitit paraprak. "Depozitat e klientëve të bankave komerciale deri më 31 maj 2019 kanë qenë 3.4 miliardë euro, prej të cilëve depozita të ekonomive familjare kanë qenë 2.4 miliardë euro. Deri më

31 maj 2018 vlera e depozitave të klientëve të bankave komerciale ka qenë 3.1 miliardë euro, prej të cilave ekonomitë familjare përbëjnë 2.2 miliardë euro", ka deklaruar Ahmeti. Sipas tij, sa iu përket kredive, vlerat e tyre për ekonomitë familjare dhe korporatat jofinanciare kanë shënuar rritje gjatë pesëmujorit të parë të këtij viti karshi periudhës paraprake të vitit të kaluar. "Vlera e kredive për ekonomitë familjare deri në maj të 2019-s kap shifrën 1.04 miliard euro, kurse për korporatat jofinanciare 1.85 miliard euro. Në periudhën e njëjtë të vitit 2018 ishin 945.9 milionë euro kredi për ekonomitë familjare, ndërkaq 1.65 miliard euro për korporata jofinanciare", ka thënë Ahmeti.


Anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, deputeti i LDK-së, Lutfi Zharku, ka thënë

për gazetën "Epoka e re" se arsyeja e numrit të madh të depozitave dhe kredive ka të bëjë me klimën e biznesit, respektivisht mosgatishmërinë e tyre për të investuar për shkak të ambientit biznesor. "Rritja ekonomike mund të shprehet në rritjen e depozitave, mirëpo në anën tjetër kjo ka të bëjë edhe me besimin në sistemin ekonomik. Pra, në sistemin bankar. Atmosfera apo klima e biznesit nuk është aq e mirë dhe ka probleme për të investuar në biznese. Kështu që, shpesh qytetarët vendosin që më shumë t'i ruajnë paratë për ditët më të vështira sesa t'i investojnë apo multiplifikojnë", ka thënë Zharku, duke shtuar se edhe niveli i kredive dëshmon për klimën ekonomike që është në Kosovë, qoftë rritja e kreditimit apo e depozitave që nganjëherë mund të ketë edhe lëvizje të kundërta. Sipas tij, e gjithë kjo është shprehje e

klimës investive në Kosovë. Edhe drejtori i "D&D Business Support Center", Safet Fazliu, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se mbajtja e parave në formë të depozitave në banka nuk është aspak e leverdishme. Sipas tij, e tëra kjo është për faktin se në Kosovë në vitet e fundit normat vjetore të inflacionit si dhe rritja e çmimeve kanë qenë shumë më të larta sesa interesi që bankat komerciale ofrojnë për depozita. "Andaj, një masë kaq e madhe e depozitave dhe me tendencë rritjeje nga viti në vit, pa dyshim se është një tregues i një klime dhe ambienti të pafavorshëm për investime në biznes. Nisur nga ky fakt, mund të vijmë në përfundim se ambienti për biznes është aq i pafavorshëm, që qytetarët dhe bizneset pranojnë t'i mbajnë kursimet apo fitimet e tyre në formë depozitash, ndonëse me humbje vlerë nga inflacioni dhe mos t'i investojnë ato", ka thënë Fazliu, duke shtuar se nga këndvështrimi makroekonomik ky është një tregues negativ pasi, sipas tij, paraja ka vlerë vetëm kur hedhet në qarkullim. "Tërheqja e një mase kaq të madhe nga qarkullimi dhe mbajtja e tyre në formë depozitash ndikon në ngadalësim të rritjes ekonomike. Nëse e analizojmë

strukturën e kursimeve, respektivisht depozitave, atëherë del se kjo shumë kaq e lartë e depozitave i përket një shtrese të vogël të qytetarëve, ekonomive familjare dhe bizneseve të cilat nuk shohin mundësi dhe siguri për t'i investuar ato para, për faktin se shtresa e gjerë me të ardhura mesatare si dhe ajo me të ardhura nën mesatare nuk e ka mundësinë për akumulim të kursimeve, rrjedhimisht për depozita, për faktin se kostoja e shportës së konsumatorit është më e lartë ose e barabartë me të ardhurat e tyre", ka thënë Fazliu. Ndërkaq sa i përket rritjes së vlerës së kredive, sipas Fazliut, për të ardhur te një analizë e mirëfilltë rreth impaktit të kredive duhet t'i bëjmë një analizë strukturës së destinimit të tyre. "Sipas BQK-së, në vitin 2018 vetëm 59.6 për qind të kredive që kanë marrë bizneset kanë pasur për qëllim investimin, ndërsa në anën tjetër 40.4 për qind e kredive kanë qenë të destinuara për qëllime të financimit të aktiviteteve jinvestive. Nëse bazohemi në këtë të dhënë, del se rreth 40 për qind të bizneseve kanë hyrë në kredi për të mbijetuar në treg e jo për të investuar në rritje, respektivisht zgjerim të aktivitetit të tyre", ka deklaruar Fazliu.





Gent SHKULLAKU (AFP)

Në pushime me kredi

Ngjashëm me vitet e kaluara, edhe sivjet, gjatë muajve të verës, bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare që operojnë në Kosovë ofrojnë kredi për pushime. Disa nga këto institucione financiare në uebfaqet e tyre zyrtare apo edhe përmes reklamave kanë paraqitur këtë lloji produkti për pushime, por në disa banka quhet edhe "kredi e shpejtë" ose "kredi personale"

PRISHTINË, 21 KORRIK - Në dy vjetët e fundit nuk ka statistika të sakta rreth mundësive financiare të qytetarëve të Kosovës që me mjete të kursimeve të aranzhojnë pushime verore familjare, pa pasur nevojë për një kredi bankare. Por, marrë parasysh faktin se gjendja ekonomike në Kosovë ndër vite është afërsisht e njëjtë, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2017 si dhe në vitin 2016, 70 për qind të ekonomive familjare nuk kanë qenë në gjendje të përballojnë një pushim vjetor njëjavor. Po sipas këtyre të dhënave, rreth gjysma e ekonomive familjare gjatë vitit 2017 kanë deklaruar se nuk kanë qenë në gjendje të përballojnë një shpenzim të papritur prej 500 eurosh përmes burimeve vetjake. Në pamundësi që shpenzimet për pushime t'i mbulojnë nga kursimet e tyre, shumë qytetarë zgjedhin një kredi të shpejtë për t'i mbuluar këto shpenzime. Kredi për pushime, para një viti, në njërin nga bankat komerciale në Kosovë kishte marrë edhe një qytetare e Prishtinës me emrin Adelina (emri i njohur për redaksinë). Ajo me familjen e saj kishte marrë një kredi në vlerë prej 1 500 eurosh vitin e kaluar.

Ajo tregon se një vendim të tillë e ka marrë, pasi paga që merr nuk i mundëson asaj kursime për pushime. Adelina thotë se nuk është e leverdishme të marrësh kredi për pushime. "Po, kam marrë kredi për pushime verore vitin e kaluar, në shumën prej 1 500 eurosh. Po mendoj se nuk ia vlen pasi që interesi është shumë i lartë, ndoshta mund të merret ndonjë kredi për ndonjë rast urgjent dhe jo për pushime. Por, kur i ke rrogat e vogla, sidomos në që punojmë në sektorin privat, je e detyruar në njëfarë mënyrë të hysh në kredi", tregon Adelina. Edhe Labinot Ademi thotë se ka marrë kredi për pushime, veprim ky që, sipas tij, nuk do të përsëritet më. "Po, kam marrë kredi për pushime në një bankë komerciale në Kosovë. Kamata apo interesi ka qenë i lartë. Po, unë nuk kisha mundësi tjetër që të shkoj në pushime. Ende nuk e kam paguar kredinë, kështu që nuk ia vlen", thotë Labinoti. Sado që pushimet verore janë mundësi e mirë për një familje që të kalojnë çaste së bashku larg rutinës së përditshme, Gona Berisha nga Prishtina thotë se, nëse kushtet financiare nuk i mundësojnë asaj shkuarjen në pushime, nuk do të pranonte në

asnjë formë që të merrte kredi për t'i kaluar ditët e pushimeve në ndonjë vend të caktuar. "Jo, nuk kam marrë kurrë kredi për pushime dhe as që marr. Nuk shkoj fare në pushim e kredi nuk marr. Për mua kjo është shumë e paarsyeshme", thotë Gona Berisha. Edhe ekspertë të çështjeve ekonomike nuk e arsyetojnë veprimin e shumë qytetarëve që të zhyten në borxhe e kredi për të siguruar një pushim. Mejd

Bektashi, profesor në Universitetin e Prishtinës, për "Radion Evropa e Lirë" thotë se për çdo vit bankat dhe institucionet mikrofinanciare po i joshin qytetarët që pushimet verore t'i kalojnë përmes marrjes së kredive, një ose dyvjeçare. Por, sipas tij, këto kredi kanë një normë të lartë interesi, çka më pas ndikon në mirëqenie dhe ekonomitë familjare. "Në këtë rast njerëzit që i shfrytëzojnë këto produkte paguajnë një normë të lartë të interesit. Çështja tjetër që ndërlidhet është se një pjesë e madhe e mjeteve financiare nga Kosova derdhen në shtete që pranojnë turistë nga Kosova, siç janë Turqia dhe Mali i Zi dhe me pak në Shqipëria. Është një fenomen që shumica e bankave që veprojnë në Kosovë i

kanë filialet edhe në shtetet ku shkojnë më së shumti turistë nga Kosova. Shpeshherë të njëjtat qytetarët i joshin me kushte dhe interesa më të ulëta", thotë Bektashi.

Në Kosovë operojnë dhjetë banka komerciale dhe 23 institucione mikrofinanciare. Norma mesatare e kamatave për kredi në banka është 6.6 për qind varësisht nga banka dhe lloji i kredisë, kurse në institucionet mikrofinanciare, sipas Bankës Qendrore të Kosovës, norma efektive e interesit është 20.8 për qind. Pavarësisht prej normës së interesit, vlera e kredive në dhjetë bankat komerciale ka arritur në 2.8 miliardë euro, kurse vlera e kredive në institucionet mikrofinanciare ka arritur në rreth 200 milionë euro.



Ja pse nuk ka mobilizim në mbrojtje të shtetit



Milazim KRASNIQI

Shumica e qytetarëve shqiptarë të Kosovës nuk varen nga politikat qeveritare, prandaj janë indiferentë se çfarë politikash hartohen e zbatohen. Ja pse!

1. Një numër i madh familjesh varen nga remitancat e familjarëve të tyre nga diaspora. Janë rreth një miliard euro në duart/xhepat e tyre, pa u varë ata direkt nga shteti. Ata harxhojnë paratë që nuk i fitojnë me punën e vet dhe ndihen rehat. Nuk kanë nevojë për subvencione e grante, ngase tokat i lënë batall, motin e shkojnë në vetura, në kafehane, në syneti, dasma e në të pame. 2. Një numër i madh biznesesh e njerëzish varen nga informaliteti. Janë po ashtu një miliardë euro, e pakta, që gjen-

erohen nga informaliteti. Këta tipa fërkojnë duart për aq sa vazhdon kolapsi i shtetit, që të mund të vazhdojnë kontrabandën dhe krimin e organizuar. 3. Punonjësit në institucione shtetërore e publike janë rehat me politikat joefikase të institucioneve, ngase marrin rroga të mira, për një punë që e bëjnë shkel e shko. Disa prej tyre i rrisin të ardhurat edhe me korrupsion, realisht pa u trazuar nga institucionet shtetërore. Edhe këta, pra, ndihen rehat me këtë lloj qeverisjeje dhe me këtë lloj shteti. 4. Disa të tjerë që zhvillojnë biznese legale, por duke qenë afërt me qeveritarët, fitojnë tenderë dhe favore të shumta. Edhe këta ndihen komod e nuk kanë pse të protestojnë, sepse në atë rast do të protestonin kundër interesave të veta. 5. Shumë nga të rinj e të rejtat e diplomuar në universitetet publike provinciale dhe në kolegje/kërpudhat e shumta private, e dinë si i kanë marrë diplomat dhe nuk kanë as guxim as fytyrë që të organizohen e të protestojnë


kundër gjendjes së keqe në shoqëri. Dosjet e favoreve, ose edhe të falsifikimeve të provimeve e të diplomave, e mbajnë peng pakënaqësinë e tyre. Ata më parë arratisen nga vendi, se sa që guxojnë të protestojnë. 6. Elitat intelektuale, aq sa janë, kanë kalkulimet e veta: shumë prej tyre kanë problem me biografitë dhe prandaj e mbajnë gojën mbyllur. Jo pak të tjerë janë të afërt me partitë politike dhe zhvatin favore për veten dhe për farefisën e tyre, në të katër anët. Kundër kujt duhet të protestojnë këta intelektualë?! 7. Një grumbull jo i vogël qytetarësh nuk e përjetojnë fare Kosovën si shtet të vetin. Ia injorojnë flamurin, ia injorojnë himnin, ia injorojnë historinë. Demek, e konsiderojnë vetëm si një "e keqe e domosdoshme" në procesin e bashkimit kombëtar. Rrjedhimisht, nga këta vjen jo pak destruksion politik, rrënim i imazhit të shtetit dhe konflikte politike e sociale. 8. Një pjesë e shoqërisë civile merret me tema që financohen

nga të huajt, si fjala vjen, problemi i ekstremizmit, minoritetet, problemet e grupeve LGBT, mbrojtja e qenve. Këto kontingjente të shoqërisë civile nuk kanë interes të ndryshojnë gjërat, sepse në atë rast mund t'u ndryshojnë statusi dhe t'u thahet kaqepi edhe atyre. 8. Shumë nga mediet bëjnë zhurmë, por më shumë duke ngritur disa agjenda për hesapet e veta, se sa për ta mbrojtur interesin e publikut. Disa prej tyre janë shndërruar nga zori edhe në zhatës të fondeve nga institucionet shtetërore, duke i shantazhuar: ua evidencojnë paligjshmërinë, pastaj i njoftojnë për gjetje dhe për të mos u rënë në qafë, arrijnë marrëveshje për dhënien e fondeve në formë reklamash a favoresh të ndryshme. Rrjedhimisht, as këto lloj mediesh nuk mund të jenë promotorë të ndryshimeve e aq më pak të mobilizimit qytetar. Në fakt, vetë mediet janë viktima të mungesës së rregullimeve adekuate të tregut, të konkurrencës dhe të trans-

parencës. Prandaj, për të mbijetuar sillen ngjashëm me akterët politikë, luftojnë për "tallin" e vet si të munden.

Kush po mbetet i pakënaqur? Mbetet fukaraja. Fukaraja, që është i pagojë, i pafuqishëm, i padijshëm dhe i pambrojtur. Për fukaranë tashmë janë hapur rrugët e arratisjes, ashtu që problemi po shkon drejt "zgjdhjes." Prandaj nuk ka kush reagon, nuk ka kush bën ndryshime. Natyrisht, në të gjitha grupet që u numëruan, ka idealistë, njerëz të ndershëm, atdhetarë të devotshëm. Por, në të gjitha grupet, ata janë pakicë. Prandaj nuk arrijnë të bëjnë masën kritike për të ndryshuar gjendjen. Kjo pakicë zaten bënë gjithë këtë zhurmë, në të gjitha grupet. Zhurma u merret si e mirëqenë, bile shikohet me simpati, por injorohet nga shumica, e cila pa bërë aspak zhurmë, ia imponon vullnetin e saj kësaj shoqërie të deprimuar dhe këtij shteti të pakonsoliduar, duke i mbajtur me planifikim në gjendje dialize.

7 000 vizitorë për shtatë muaj vizituan shpellën e Gadimes



LIPJAN, 21 KORRIK - Shpella e Gadimes vazhdon të mbetet një nga atraksionet turistike kryesore të vendit, ku për shtatë muajt e parë të vitit kjo shpellë ka pritur afër 7 000 vizitorë. Vizitorët tashmë i janë shtuar edhe më shumë meqë shumë mërgimtarë që kanë ardhur për pushime preferojnë që një ditë ta kalojnë në shpellën e mermertë.

Shpella e Gadimes me të gjitha elementet e saj çdo ditë e më shumë po tërheq numër të madh të vizitorëve edhe nga jashtë Kosovës, të cilët duan që nga afër ta shohin këtë shpellë të mermertë që është e vetmja në Evropë e llojit të tillë.

E diela për ciceronin e kësaj shpelle, Fatmir Bytyçi, është tejet e ngarkuar me punë, pasi ai për shumë grupe gjatë gjithë ditës jep shpjegime. Vendi i parë ku ndalen vizitorët është "Fontana e dëshirave", ku ata gjuajnë monedha me bindjen se dëshirat do t'u plotësohen.

Arrestohet një serb i dyshuar për krime lufte në Lipjan

LIPJAN, 21 KORRIK (ER) - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se është arrestuar një serb nën dyshimet për krime lufte kundër popullsisë civile në komunën e Lipjanit. Në të njëjtën kohë, Prokuroria ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë masën e paraburgimit për personin me inicialet G. S.

Në njoftimin e prokurorisë thuhet se "ekziston dyshimi i bazuar, se i dyshuari më 15 dhe 16 prill të vitit 1999, së bashku me të dyshuar të tjerë, pjesëtarë të njëjësive rezervë të ushtrisë dhe policisë serbe, gjatë një ofensive kundër popullsisë civile në Komunën e Lipjanit dhe rrethinë, përmes përdorimit të forcës ushtarake, plaçkitjes,

dhunës dhe frikësimit, e kanë dëbuar popullsinë civile nga shtëpitë e tyre, pastaj nga familjet të cilat po përpiqeshin të largohen, të pandehurit i kanë ndarë dhjetëra persona, të cilët më pas i kanë vlarë". Mbi bazën e këtyre veprimeve Prokuroria Speciale ka ngritur akuzën për "krime lufte ndaj popullsisë civile".



Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (6)

Sqarimi i fushës antimagnetike



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Kurse kahja e kësaj fushe që buron nga anët anësore është e kundërt me fushën magnetike që buron nga polet magnetike, prandaj këtë fushë unë do ta quaj fushë antimagnetike ((-B) ?) e vet atij magneti.

Marrim dy vija të fushës magnetike (A B) që kalojnë nëpër cilindrin magnetik me pole (N S), polet e të cilat janë të mbuluara me pllaka nga hekurit (A) dhe (B) (shih figurën 30).

Siç po shihet nga figura, vija (a) arrin të kalon përtej momenteve magnetike të pllakës së polarizuar (B) dhe kalon nga sipërfaqja e jashtme e pllakës së hekurit (B) duke hyrë në pllakën e hekurit (A) që është e vendosur mbi polin magnetik (S).

Kjo quhet fusha magnetike e magnetit (N S), dhe shënohet me ((B)) ?, sepse ka kahje të njëjtë dhe drejtim të njëjtë me fushën magnetike që buron nga poli magnetik (N) dhe hyn në polin magnetik (S) kur nuk janë prezentë pllakat.

Nga ana tjetër, për dallim nga vija (a) tani vija (b) nuk mund t'i kalojë pengesat që në këtë rast janë momentet magnetike të pllakës së hekurit (B).

Kjo ndalesë e detyron vijën e fushës magnetike (b) që ka ngelë midis poleve magnetike të fryhet dhe të eksplozojë nga mesi i magnetit dhe të zgjerohet në të gjitha drejtimet ngjashëm sikur fusha magnetike ((B)) ?.

Prandaj kjo fushë magnetike që buron nga ana anësore e poleve magnetike unë do ta quaj fushë antimagnetike ((-B) ?) sepse ka kah të kundërt, intensitet të ndryshëm dhe drejtim të njëjtë me fushën magnetike.

Ligi i ri mbi praninë e fushës antimagnetike ((-B) ?)

Fusha antimagnetike lind atëherë dhe vetëm atëherë kur polet magnetike të magnetëve mbulohen me materiale ferromagnetike, dhe buron vetëm nga ana anësore e magnetëve në mes të dy poleve magnetike, si dhe ka kahje të kundërt me fushat magnetike ((B)) ? të vetë atij magneti nga i cili buron fusha antimagnetike ((-B) ?).

Argument

Tani kthehemi edhe një herë te krijimi i fushës magnetike nga tornadot elektromagnetike te toka, dielli dhe secili trup tjetër qiellor që posedon fushë magnetike me

një intensitet të caktuar.

Në momentin kur është formuar fusha magnetike e këtyre trupave qiellorë, nën veprimin e forcës tërheqëse të poleve magnetike, por edhe me ndihmën e fenomenit të tornados elektromagnetike, tërë materialin likid të hekurit e kanë tërhequr dhe bartur nga të gjitha anët në drejtim të poleve magnetike.

Kjo masë e hekurit mbi polet magnetike të këtyre trupave qiellorë është magnetizuar, prandaj të dy polet magnetike nën veprimin e forcës tërheqëse, i kanë tërheqë në drejtim të poleve magnetike (N S) momentet magnetike nga shtresat e hekurit likid që është grumbulluar mbi polet magnetike (shih figurën 31 a).

Lëvizja e këtyre momenteve magnetike nga shtresat e hekurit në drejtim të poleve magnetike ka drejtim të njëjtë dhe kahje të kundërt.

Në këtë mënyrë intensiteti i fushës magnetike është rritur në hapësirën në mes të dy polet magnetike dhe shtresës së hekurit, në vlerën proporcionale me intensitetin e fushës magnetike të vetë magnetit, dhe masën e hekurit të polarizuar mbi polet magnetike. Kjo vlerë mund të jetë edhe dhjetëra apo qindra herë më e madhe.

Kjo rritje e fushës magnetike qarkullon nga poli magnetik i jugut (S) në drejtim të polin magnetik të veriut (N).

Në momentin kur ky fluks magnetik arrin në polin magnetik të veriut (N) një pjesë kalon nga ky pol magnetik në formë të fushës magnetike dhe zgjerohet në të gjitha anët, kurse pjesa më e madhe ndalon në dalje të polin magnetik (N) për shkak të prezencës së momenteve magnetike që janë formuar në shtresën likide të hekurit.

Në këtë rast, për shkak të kësaj pengese nga sipërfaqja e dipoleve magnetike të këtyre trupave qiellorë, shpërthejnë fushat antimagnetike që kanë kah të kundërt me fushat magnetike po të këtyre trupave qiellorë.

Veprimi i fushës antimagnetike të tokës mbi fushën magnetike

Kjo fushë antimagnetike ((-B) ?) që buron nga mesi i magnetit në formë të një eksplozimi të fuqishëm, i godet vijat reale të fushës magnetike ((B)) ? dhe i largon me forcë shtytëse nga sipërfaqja e magnetit, nga pozicioni (d1) në (d2) varësisht nga intensitetit të fushës antimagnetike (shih figurën 34).

Ky largim i vijave të fushës magnetike shkakton rënien e intensitetit të fushës magnetike ((B)) ? në mesin e magnetëve ashtu siç u vërtetua në eksperimentin numër 8 ku kishim rënie të intensitetit të fushës magnetike pas vendosjes së pllakave të hekurit nga 210 mT në 85mT.




Fig 30




Fig 31

$$(-B) = B \cdot \frac{d_N}{d_S} \cdot \frac{(+B_{N \rightarrow S})}{(+B_{N \rightarrow N})} \text{njësia} = T \frac{m}{m} \cdot \frac{+T}{-T} = T$$

Ligi i zbritjes së fushës magnetike

Shkaktar kryesor që e zbrat intensitetin e fushës magnetike të një magneti janë vetëm fushat antimagnetike ((-B) ?) që burojnë nga vetë ai magnet. Vijat e fushës antimagnetike ((-B) ?) i godasin vijat e fushës magnetike ((B)) ? dhe i largojnë në distanca të ndryshme varësisht nga intensiteti i fushës antimagnetike të atij magneti ((-B) ?) dhe materialeve ferromagnetike që ndodhen mbi polet magnetike të magnetëve permanente.


Argument

Shkaktar kryesor që e zbrat intensitetin e fushave magnetike te toka, dielli apo çdo trup tjetër qiellor janë prezenca e hekurit likid mbi polet magnetike dhe fusha antimagnetike që buron nga këta trupa qiellorë.

Zbritja e intensitetit të fushës magnetike te toka, nga këta dy faktorë jetikë të lartpërmendur, planetin tonë e ka shndërruar në një planet të banuar për njeriun. Prandaj fusha antimagnetike e tokës, jo vetëm që e shpërndanë intensitetin e fushës magnetike të tokës, por na mbron edhe nga fushat magnetike të diellit dhe të gjithë trupave të tjerë qiellorë.

Intensiteti i fushës antimagnetike i tokës

Eksperimentalisht prezencën e fushës antimagnetike ((-B) ?) e kam gjetur, por intensitetin e fushës antimagnetike ((-B) ?) nuk ekziston ndonjë aparat që e detekton dhe e bën matjen e saj.



<<B<< Antifusha magnetike
<<B<< Fusha magnetike (N-S)
>>B>> Fusha magnetike qendër të magnetit

Fig 31

>>B>> Antifusha magnetike
>>B>> Fusha magnetike (N-S)
<<B<< Fusha magnetike qendër të magnetit

Fig 32

Gjithashtu llogaritja precize e fushës antimagnetike ((-B) ?) është tejet e ndërlikuar dhe tani është shumë problematike një formulim i saktë për llogaritjen e këtij intensiteti. Intensiteti i fushës antimagnetike varet nga shumë faktorë që e rrethojnë.

Intensiteti i fushës magnetike ((B) ?) të vetë magnetit

Sasia e materialeve ferromagnetike që ndodhen mbi polet magnetike të atij magneti si dhe intensiteti i fushave magnetike ((B) ?) dhe antifushave magnetike ((-B) ?) të trupave të gjithë trupave që e rrethojnë atë magnet.

Ndikimi i fushës magnetike të trupave të tjerë qiellorë qoftë i diellit, Jupiterit, Saturnit, Uranit, Neptunit dhe trupave të tjerë qiellorë mbi tokën nxirret nga eksperimenti numër 6, vetëm se në këtë rast pllakës së hekurit e cila është e polarizuar me polet (N S), ia afrojmë magnetet ma pole të njëjta (N N) dhe të kundërta (N S) rezultati ndryshon.

Polet e njëjta të pllakës së hekurit dhe magnetit (S S), ndikojnë në rritjen e fushës magnetike në mes të magnetit, e cila ndikon në zvogëlimin e fushës antimagnetike të tij (shih figurën 31).

Kurse polet e kundërta të pllakës së hekurit dhe magnetit (N S), ndikojnë në zvogëlimin e fushës magnetike në mes të magnetit e cila ndikon në rritjen e fushës magnetike të tij (shih figurën 32).

Argument

Llogaritja e saktë e fushës antimagnetike që buron nga toka është proces tejet i komplikuar

sepse kjo varet nga shumë faktorë. Vlera e intensitetit të fushës antimagnetike të tokës nuk është konstante, kjo ndërron kohë pas kohe dhe nga një vend në tjetrin.

Faktorët që ndikojnë në intensitetin e fushës antimagnetike janë: Intensiteti i fushës magnetike mbi polet e dipolit magnetik të tokës, shtresa përkatësisht masa e hekurit që ndodhet mbi polet magnetike, distanca e Hënës nga toka, dhe pozita e Hënës ndaj tokës, distanca e tokës nga dielli, dhe trupave të tjerë qiellorë, dhe prezenca e fushave magnetike dhe antimagnetike e të gjithë trupave qiellorë nëpër të cilat kalon toka.

Një formulim më i saktë për ta llogaritur intensitetin e fushës antimagnetike që buron nga një trupë qiellorë, nëse marrim parasysh fushat magnetike dhe fushat antimagnetike të trupave të tjerë qiellorë që veprojnë mbi atë trup, llogaritet përmes këtij formulimi.

Por për t'i thjeshtësuar gjërat intensitetin e fushës antimagnetike nëse nuk marrim parasysh fushat magnetike dhe antimagnetike që veprojnë mbi atë trup e llogarisim nga formulimi:

((-B)) ? = B ? od d_N/d_S njësia = $Tm/m = T$

((-B)) ? intensiteti i fushës antimagnetike

B ? intensiteti i fushës magnetike mbi polet e dipolit magnetik (N S) të atij trupi qiellorë
 d_N Trashësia e hekurit mbi polin magnetik (N)
 d_S Trashësia e hekurit mbi polin magnetik (S)

((+/- B_(N?S))) ? ? intensiteti i fushave magnetike dhe antimagnetike që burojnë nga polet (N) dhe bien në polin(S) të atij trupi.
((+/- B_(N?N))) ? ? intensiteti i fushave magnetike dhe antimagnetike që burojnë nga polet (N) dhe bien në polin(N) të atij trupi.

Sqarim

Raporti në mes d_N dhe d_S i marrim si të barabarta, por te trupat qiellorë vështirë të jenë të barabartë, gjithmonë poli magnetik i veriut (N) ku buron fusha ka intensitet më të lartë. Kjo është vërejtur edhe në sqarimin e figurës 20. Prandaj trashësia e materialit të hekurit mbi polin magnetik (N) thajse gjithëherë është më e madhe sesa te poli magnetik (S). Këtë mund ta vërejmë eksperimentalisht nëse një sferë të hekurit e vendosim në mes të magnetit, ajo do të shkojë në drejtim të polin magnetik të veriut (N). **Vijon.**

Irani paralajmëron Britaninë për eskalim të situatës

TEHERAN, 21 KORRIK - Londra ka dënuar konfiskimin e anijes së saj në Gjirin Persik nga Teherani duke theksuar se ka qenë duke operuar në mënyrë ligjore në territorin e Omanit, kur u rrethua nga forcat iraniane. Komentet vijnë pas lansimit të një videoje nga Garda Revolucionare e Iranit, ku shihen duke e rrethuar cisternën e naftës. Ngjarjet e fundit në Ngushticën e Hormuzit, një nga pikat më të rëndësishme të tregtisë ujore në

botë, ka ngritur tensionet në mes të Teheranit dhe Perëndimit, gjë që ka rritur frikën për ndonjë konflikt të mundshëm të armatosur. Sekretarja britanike e Mbrojtjes, Penny Mordaunt, tha se konfiskimi i anijes Stena Impero ka qenë "veprim armiqësor", derisa sekretari i Jashtëm, Jeremy Hunt, u shpreh i zhgënjyer gjatë një telefonate me homologun iranian Mohammad Javad Zarif. Zarif i tha Huntit se anija - për të

cilën Irani thotë se ka shkelur ligjet ndërkombëtare - duhet të kalojë nëpër procedura ligjore para se të lirohet. Marrëdhëniet mes Iranit dhe Perëndimit janë acaruar pas konfiskimit nga autoritetet britanike të cisternës Grace 1 që kontrollohej nga Irani më 4 korrik, nën dyshimet se po bënte bartjen e naftës në Siri, në kohën e sanksioneve nga shtetet evropiane. Udhëheqësi suprem i Iranit, Ayatollah Ali Khamenei, kishte



thënë se Teherani do të hakmerret ndaj konfiskimit të cisternave nga autoritetet britanike. Cisterna iraniane dhe ekipi i saj vazhdojnë të

jenë nën kontrollin e autoriteteve të Gjibraltarit, derisa Stena Impero e Britanisë është duke u mbajtur nga autoritetet iraniane.

Uashingtoni i përçarë politikisht mbi racën dhe ideologjinë

Dënimi nga Dhoma e Përfaqësuesve i komenteve raciste të Trumpit dhe ndarja e demokratëve mbi çështjen e fillimit të procedurave për shkarkimin e tij ka zhytur vendin në një debat të ashpër mbi racën, emigracionin dhe ideologjinë politike

WASHINGTON, 21 KORRIK - Java e kaluar ishte sfiduese për demokracinë amerikane. Presidenti Donald Trump po kritikohet për sulmet ndaj katër ligjvënësve demokrate që iu përkasin pakicave. Dhoma e Përfaqësuesve, kryesisht në linja partiake, votoi për t'i dënuar disa nga komentet e presidentit që ajo i cilësoi si raciste. Në të njëjtën kohë, demokratët e opozitës mbeten të ndarë mbi çështjen e fillimit të procedurave për shkarkimin e presidentit Trump apo përqendrimin e energjisë në mposhtjen e tij në zgjedhjet presidenciale të vitit të ardhshëm. Përplasja ka zhytur vendin në një debat të ashpër mbi racën, emigracionin dhe ideologjinë politike. Para një turme entuziaste në Karolinën e Veriut, presidenti Trump sulmoi përsëri katër ligjvënës demokrate, të gjitha grame ngjyrë. "Këta ideologë të krahut të majtë e shohin vendin tonë si një forcë të së keqes. Ato flasin keq për vendin tonë. Ato duan ta shkatërrojnë Kushtetutën, ta dobësojnë ushtrinë tonë dhe t'i eliminojnë vlerat mbi të cilat është ndërtuar

ky vend i mrekullueshëm", tha Trumpi, ka njoftuar vova. Në një moment gjatë fjalimit të tij, presidenti vuri në shënjestër ligjvënësen e Minesotës Ilhan Omar, duke nxitur thirrjet nga turma "kthejeni në vendin e saj". Paraqitja konfrontuese e presidentit Trump ndodhi në të njëjtën ditë që Dhoma e Përfaqësuesve votoi kundër një nisme për t'i filluar procedurat e shkarkimit të tij. Por më parë gjatë javës, Dhoma e Përfaqësuesve bëri një hap të pazakontë, duke votuar për t'i dënuar dhe cilësuar si raciste disa nga sulmet e presidentit Trump ndaj katër ligjvënësve demokrate. Të gjithë demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve mbështetën rezolutën, përfshirë aktivistin e të drejtat civile John Lewis nga Xhorxhia. "Unë e di se çka është racizmi dhe mund ta ndiej atë. Në nivelin më të lartë të qeverisë nuk ka vend për racizëm", tha ai. Fitorja e presidentit Trump në vitin 2016 u ndihmua nga mbështetja e fortë e votuesve të bardhë të shtresës punëtore. Por shumë demokratë, përfshirë ligjvënësin Tom Malinowski, besojnë se presidenti është duke



bërë një ofertë të rrezikshme për mbështetje bazuar në pakënaqësinë racore. "Këto nuk janë vetëm fjalë. Ato janë njësojë sikur t'i hedhësh zjarrin benzinë dhe që mund t'i acarojnë mendjet e trazuara të njerëzve", tha ai. Presidenti Trump ka mohuar akuzat se është racist, por ka sulmuar katër ligjvënës, duke i quajtur ato socialiste dhe u ka thënë atyre të largohen nga vendi nëse nuk janë të kënaqura. Disa republikanë i kanë kritikuar sulmet, por shumë të tjerë, duke përfshirë senatorin John Kennedy, e mbështesin presi-

dentin. "Ky vend nuk është si Kina ose si Koreja e Veriut. Kjo është Amerika dhe nëse ju urreni vendin tonë, ju jeni të lirë të largoheni kur të doni", thonë ata. Fokusi i presidentit te tensionet racore dhe ideologjike po e gris strukturën e vendit, paralajmëron ligjvënësi demokrat Dean Phillips. "Nëse racizmi bëhet një çështje partiake në këtë vend, ky do të ishte një abuzim ndaj themeluesve të vendit tonë, Kushtetutës sonë dhe çdo personi që e quan Amerikën shtëpi të tyre", tha Phillips. Fitorja e ngushtë e presidentit

Trump në vitin 2016 dhe mbështetja relativisht e ulët për punën e tij ia vështirëson atij përpjekjet për t'u rirzgjedhur, thotë analisti Kyle Kondik. "Nëse mbështetja për punën e tij është nën 45 për qind, atëherë ai do të ketë nevojë për votat e një pjese të konsiderueshme të njerëzve që nuk e mbështesin atë dhe në këtë pikë gjërat do të jenë tepër të vështira për të", tha ai. Retorika tensionuese e kësaj jave mund të shërbejë si një hap paraprak i një fushate të acaruar dhe të paqëndrueshme presidenciale vitin e ardhshëm.

Në Ukrainë janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare

KIEV, 21 KORRIK - Ukrainasit kanë votuar të dielën në zgjedhje të parakohshme parlamentare, që mund ta konsolidojë fuqinë e presidentit të zgjedhur kohët e fundit. Në sajë të mbështetjes së madhe popullore, në muajin prill president i Ukrainës u zgjodh Volodimir Zelenskiy, një komedian që pati luajtur rolin e presidentit në një varietet televiziv që fitoi popullaritet të

madh. "Duke thirrur zgjedhje të parakohshme, presidenti i ri shpreson ta ruajë frymën e fitores së tij presidenciale", thotë ekspertja Agnese Ortolani. "Ai mbështetet në këtë përpjekje nga shumica e ukrainasve, që e konsiderojnë parlamentin si një institucion të korruptuar dhe i kanë besuar Zelenskiy mandatin për "pastrimin e klasës politike", tha ajo.

Partia në Shërbim të Popullit e Zelenskiy pritet të paraqitet mirë në zgjedhje, por mund të mos sigurojë dot shumicën absolute, duke u detyruar të formojë një koalicion qeverisës. Analistët thonë se përbërja e parlamentit të ri mund të duket shumë e ndryshme nga parlamenti i mëparshëm, me deri në 70 për qind të anëtarëve ligjvënës të rinj.



KONKURS**EDUKIDS NË FERIZAJ, SHPALL KONKURS:**

- Edukatore - 3 vende të lira;
- Motër Edukatore - 3 vende të lira;
- Kuzhinierë - 1 vend i lirë;
- Pastruese - 1 vend i lirë.

Për të qenë pjesë e EduKids në Ferizaj, ju duhet t'i plotësoni këto kushte dhe kritere:

- Edukatore dhe motër edukatore
Të keni të kryer Fakultetin e Edukimit (Drejtimi Parashkollor, Pedagogji);
Të keni të kryer Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm;
Drejtimi i Peditrisë; Drejtimi Mamisë ose edhe Fakultetin e Mjekësisë - Drejtimi Infjermeri (vlen vetëm për motër edukatore);
Përvojë pune;
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me fëmijët;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar, energjikë dhe emocionalisht te gatshëm për t'u përballuar me situata emergjente;
Të njihni mirë psikologjinë dhe botëkuptimin e fëmijeve;
Të jepni ndihmën e parë në rastet emergjente.

- **Kuzhinierë**

Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me stafin dhe fëmijët;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

- **Pastruese**

Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

Kandidatet e interesuara duhet të kompletojnë dokumentet:

CV;
Diploma dhe çertifikatat e trajnimeve (nëse keni);
Dëshmitë mbi punët paraprake (nëse keni punuar më herët);
Çertifikata e lindjes.

Të gjitha këto dokumente duhet të dërgohen në adresën: edukids05@gmail.com
Për info shtesë, kontaktoni EduKids +383 45 714 713 (viber&whatsapp)
KONKURSI MBETET I HAPUR DERI MË 31 KORRIK 2019

Vetëm kandidatet e kualifikuara do të ftohen për intervistë

**KONKURS**

- Edukatore** - 3 vende të lira
- Motër Edukatore** - 3 vende të lira
- Kuzhinierë** - 1 vend i lirë
- Pastruese** - 1 vend i lirë

CV-të e kompletuara me dokumentet e kërkuara
dërgohen në: edukids05@gmail.com deri në datën **31 Korrik 2019**

Për info shtesë, kontaktoni: **+383 45 714 713**



E rrallë

Dashurohet me stjuardesën, lajmëron për bombë në avion

Një 65-vjeçar nuk arriti ta fitonte zemrën e një stjuardese në fluturimin e kompanisë 'Lufthansa' nga aeroporti i Beogradit për Frankfurt, saqë lëshoi alarmin për një bombë në avion, në mënyrë që ai të mos nisej dhe stjuardesa të mbetej aty. Pas alarmit, për të marrë masa, ishin evakuuar 130 pasagjerë të cilët ishin në bordin e avionit dhe pesë anëtarë të ekuipazhit, mes



të cilëve edhe stjuardesa që 'çmendi' telefonuesin. Pas kontrolleve të kujdesshme u vërtetua se nuk ka asnjë bombë në bord, aeroplani u nis pastaj për në Frankfurt.

FOTO E DITES



Njerëzit ecin në urën për këmbësorët gjatë vizitës në akullnajën më të madhe të Francës. /AFP/

E jashtëzakonshme

Mysafiri i paftuar, tigrin hyn në shtëpi

Një familje në Indi është befasuar nga një mysafir i paftuar që kishte hyrë në shtëpinë e tyre. Ata gjetën tigrin duke u relaksuar në shtratin e shtëpisë së tyre pas përmbytjeve vdekjeprurëse në Azinë jugore. Imazhet e publikuara në mediat sociale tregojnë kafshën



e madhe duke qëndruar në shtratin e familjes së pidentifikuar në fshatin Harmuti.

BARSOLETA E DITËS



- Ua sa qenke dobësuar!
- E thua për të ma bërë qejfin, më duket.
- Qenke bërë edhe më e zgjuar!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray




Ne ora 22:00

"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI
Gjithçka që nuk ka ecur sipas

planeve tuaja sot mund të rivlerësohet nëse paraqitet një situatë e re.



DEMI
Me kalimin e Hënës në shenjë ju

do të bëheni shumë të dashur me njerëzit që ju rrethojnë dhe partnerin. Nuk do të ndaleni në surpriza sot.



BINJAKËT
Pozitiviteti dhe energjitë e mira sot

do t'ju kaplojnë gjatë ditës. E rëndësishme është të ndiheni mirë.



GAFORRJA
Një ekuilibër i përkryer midis

dashurisë dhe karrierës sot do të bëjë që ju të jeni epiqendra e shumë situatave interesante.



LUANI
Sot duhet t'ia dilni mbanë vetë një

problemi që mund të lindë në punë. Edhe pse jeni dyshues në aftësitë tuaja, do të keni përfundime të shkëlqyera.



VIRGJËRESHA
Ndihehi disi të zhgënjyer nga

partneri sot sepse nuk ka të njëjtin përkushtim si ju në lidhje. Mbase ngaqë karakteret tuaja ndryshojnë.



PESHORJA
Sot dita paraqitet shumë e këndshme

saqë në çaste të caktuara do t'ju duket sikur keni ikur përsëri me pushime.



AKREPI
Sot do të mbi-zotërojnë ndjenja e

xhelozisë në ditën tuaj. Edhe për situatë shumë të pafajshme fajtor do ta bëni partnerin.



SHIGJETARI
E keni nisur ditën me shumë

vull dhe po kështu do ta përfundoni. Keni energji pa fund dhe iniciativat e reja që keni ndërmarrë po ju pëlqejnë.



BRICJAPI
Sot duhet të jeni më konkret në

planet dhe punët tuaja. Shumë ide dhe mendime nuk po arrini t'i konkretizoni në praktikë.



UJORI
Çdo gjë shkon mirë me partnerin

dhe miqtë tuaj, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për financat. Po ndieni që keni nevojë për disa të ardhura më tepër.



PESHQIT
Do të merrni një mesazh

mjaft të qartë nga personi për të cilin po mendoni kohë e fundit. Pritet një dashuri e re në horizont.


Publikohet kënga e re e Noizyt



Është publikuar projekti më i ri i Noizyt. Pas një kohe të gjatë pa këngë të reja, reperi ka sjellë videoklipin me


titull "Nuk kanë besu". Muzika është realizuar nga OTR Records, ndërkaq tekstin e ka shkruar Noizy.

Ku dhe me kë e festoi ditëlindjen Priyanka Chopra?



Priyanka Chopra festoi të shtunën ditëlindjen. Aktorja 37-vjeçare ishte e shoqëruar nga bashkëshorti i saj Joe Jonas për festën madhështore në Miami. Priyanka pati të veshur një fustan të

kuq i cili shkëlqente i tëri, me një kurorë të vendosur në kokë që shkruante "Vajza e ditëlindjes". Më vonë, çifti u bashkua nga familja dhe miqtë për ta prerë tortën e madhe të gatuar vetëm për aktoren.




Justini dhe Hailey presin në radhë si gjithë njerëzit e tjerë

Justin Bieber dhe bashkëshortja e tij Hailey u panë me kafe në Beverly Hills në Kaliforni. Këngëtari dhe modeluesja më pas u panë në një restorant i cili është i njohur për mospranimin e

rezervimeve. Çifti u pa në tryezën e jashtme derisa prisnin si gjithë të tjerët. Justini pati të veshur rroba nga linja e tij Drew, ndërkaq Hailey këmishë dhe pantallona të shkurtra.

Ne-Yo thotë se kapelat janë si fëmijët e tij



Këngëtari, tekstshkruesi, producenti, aktori dhe valltari, Ne-Yo, që pothuajse asnjëherë nuk shihet pa kapelë në kokë, së fundmi ka treguar se sa i rëndësishëm është ky aksesori për të. Gjatë paraqitjes së tij në një

festival në Miami, fansat e kanë lutur Ne-Yo që ta hedhë kapelën e tij drejt turmës. Por ai ka dhënë një përgjigje për fansat: "Ju e dini se këto kapele për mua janë si fëmijët e mi. Unë nuk mund thjesht t'i hedh fëmijët e mi".

FOTOGAZETARIA E LUFTËS



SHPRESË MULLIQI

Ngjarjet i mbulonin ngjarjet

Nëse do t'i referohemi edhe një herë në këtë punim numrit 6 të revistës "Kombi", do të shohim se në fundshkurt dhe në fillimars të vitit 1998 kishin ndodhur shumë ngjarje epike dhe tragjike në të njëjtën kohë. Kështu, ta zëmë, po në numrin 6 të "Kombit" reporterët dhe fotogazetarët e kësaj reviste do të sjellin, së bashku me shkrimet e faktuara, edhe një serë fotografish që kishin të bënin me rastin e dy masakrave të bëra më 28 shkurt të vitit 1998 në Likoshan të Drenasit dhe në Qirez të Skenderajt, fshatra këta që ndërmjet vete i ndante një përrua i vetëm. Bashkë me rrëfimin e saj, "Kombi" sjell fotografinë e plakës Dinore Ahmeti²⁶, së cilës pushtuesit serbë i vranë në Likoshan 11 anëtarë të familjes, më pas edhe fotografinë e Sefer Nebihut²⁷ nga Qirezi, të cilit në aksionin kriminal të policisë serbe iu vranë djemtë Gjeshiri dhe Iliri si dhe reja Rukija, shtatzënë në muajt e fundit para lindjes. "Kombi" në këtë artikull botoi edhe imazhe të barbarisë serbe dhe vendet ku ishin vrarë Rexhep dhe Naser Gjeli²⁸, por as kësaj radhe "Kombi" nuk botoi pamjet e njerëzve të vrarë siç ishin katër vëllezërit Sejdiu nga Qirezi, apo kufomat e njëmbëdhjetë anëtarëve të masakruar të familjes Ahmeti, të cilët u sollën nga morgu i Prishtinës, madje të paekzaminuar, e mbi të cilët viheshin re gjurmët e torturës çnjerëzore që i kishin bërë serbët mbi këta civilë të paarmatosur.

Po në këtë numër, bashkë me shkrimin përcjellës, autorja e këtij punimi, bashkë me fotoreporterin Emin Emini, në shkrimin me titull: "Familja e Avdullah Nikës nuk e di përse ka ndodhur vrasja"²⁹ sjellin edhe pamje me familjarët e Avdullah Nikës nga Gllanasella e Drenasit, i cili u masakrua nga serbët në vendin e tij të punës, në Çikatovë të Vjetër, në punktun për shpërndarje ndërkombëtare të energjisë elektrike.³⁰ Këto pamje dhe biseda u realizuan vetëm një natë para se të

sulmoheshin Likoshani dhe Qirezi, fshatra këta në fqinjësi të parë të Gllanasellës. Po në këtë numër, gazetari i "Kombit", Zymber Kelmendi, bashkë me artikullin e tij me titull "Pamja rishtuese në rrethojën e fabrikës së municionit: koka të prera të qenve si simbol i kërcënimit të paramilitarëve serbë ndaj shqiptarëve"³¹, sjell edhe pamje nga Prekazi vetëm një ditë para se të sulmoheshin

Kryeredaktori i "Kombit" i bëri disa fotografi, por ato nuk u botuan asnjëherë në revistë. "Nuk doja. Nuk kisha dëshirë që familjarët e ngushtë t'i shohin ato foto. Dhembja e tyre ishte edhe ashtu e madhe".³⁶ Por, e veçanta ishte se, më pas, pikërisht me ato dy fotografi, Sokol Dobruna³⁷ me disa të tjerë shkuan në Skivjan të Gjakovës ku jetonte një familje nga Gllogjani. Aty u kuptua se fjala ishte për Agron dhe

Pamje shumë ekskluzive në këtë numër të "Kombit" vijnë nga gazetarja Donikë Shahini e cila në reportazhin: "Ata u vranë dhe u masakruan, nga pesë deri në shtatëdhjetepesë".⁴⁰ D. Shahini besojmë të ketë qenë gazetarja e parë që është futur në ambientet e shtëpive të familjes së Shaban Jasharit, pas 5, respektivisht 6 marsit. Ajo në këtë ekspeditë ishte e shoqëruar nga një gazetar japonez dhe një tjetër italian, të cilët ia mundësuan që, si përkthyes e tyre, të futej te Jasharët. Numri 9 i revistës "Kombi", bashkë me një foto nga një ceremonial varrimi, sjell edhe kryetitullin e shënuar me shkronja të mëdha: "KJO ËSHTË LUFTË".⁴¹ Në brendësi të gazetës kemi shkrime që sjellin pamje të cilat dëshmojnë se ajo që po ndodhte në Kosovë ishte një nismë e cila popullin e këtij vendi⁴² duhej ta shpinte drejtë lirisë, pa ndonjë alternativë tjetër.

tre luftëtarët e lirisë: Ilaz Kodrën, Sami Lushtakun dhe Jakup Nurën.⁴³ Këta tre luftëtarë, tashmë ishin eprorë të lartë të UÇK-së, por njiheshin edhe si tre luftëtarë të orëve të para dhe bashkëluftëtarë të komandantit Adem Jashari. Intervista me Sami Lushtakun, Iliaz Kodrën dhe Jakup Nurën, që u realizua nga H. Mulliqi, u botua në numrin në vijim të "Kombit".⁴⁴ Një fotografi impozante e Sami Lushtakut u botua në ballinë të revistës. Revista u shit për më pak se 40 minuta në gjithë Kosovën me një tirazh prej 70 mijë kopjesh. Më 17 maj 1998 në shtypshkronjën "Koha" u rishty edhe një tirazh i plotë i revistës, ngaqë nevojat ishin marramendëse. Ndërsa drejtori i "Kombit", Haki Mulliqi, kujton sot me sa vijon: "Tirazhi në fjalë arriti në 150 mijë kopje, por jam i sigurt se, po të kishim mjete, revista mund të arrinte një tirazh prej të paktën 400 mijë kopjeve".⁴⁵ Në ditët në vijim, në demonstratat që organizoheshin në Prishtinë, ballina e revistës, tok me portretin e Sami Lushtakut, u gjet në duart e demonstruesve. Ata e thërrisnin emrin e luftëtarit S. Lushtaku, i cili pas një kohe do të emërohej komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për Zonën Operative të Drenicës. Reporterët dhe fotoreporterët e "Kombit" ishin të palodhshëm dhe vepruan në të gjitha zonat e luftës: Haqif Mulliqi në zonën e Drenicës, të Llapit, të Shalës dhe të Karadakut; Emin Emini në zonën e Drenicës dhe atë të Shalës; Donikë Shahini në zonën e Drenicës dhe atë të Dukagjinit, Shpresë Mulliqi në zonën e Drenicës dhe atë të Dukagjinit dhe të Shalës; Musa Kurhasku në Zonën e Dukagjinit dhe atë të Pashtrikut; Izedin Krasniqi në zonën e Shalës;



Jasharët, me ç'rast kishte shkruar për zhdukjen e Idriz Idrizit nga ky fshat. Mbase një prej karakteristikave të "Kombit", pas fillimit të shtrirjes së luftës në Kosovë, është se në ballinë, ku jo rrallë janë sajuar kolazhe të fotografive që ishin një dëshmi e asaj që kishte ngjarë ndërmjet dy numrave, por edhe një si udhëzues për lexuesit mbi atë se çfarë përmbante numri vijues i revistës. Shembull mbase mund të jetë numri 7 i revistës "Kombi", i datës 31. 3. 1998, i cili sjell shumë të dhëna mbi atë se ç'po ngjante në Kosovë në atë kohë, ndërsa tek lexuesit e shtonte besimin në shkrimet e revistës si dhe i arsyetonte pritjet e mëdha se reporterët, fotoreporterët dhe gazetaret e "Kombit", të cilët, për asnjë herë tëdysheme ishin të shtrirë dy djem të rinj, të shpuar nga projektilet e pushkëve serbe.

Gazmend Mehmetajn. Ky numër i "Kombit" sjell edhe pamje të tjera të bëra gjatë vizitës së janarit në shtëpinë e Jasharëve, siç është ajo e përmendur më sipër me vajzat e mëdha të familjes; më as edhe një fotografi të tërë familjes së vrarë të Hamëz Jasharit; pamje nga ajo se si është dukur shtëpia më 28 janar (foto e bërë nga autorja e këtij punimi) si dhe pamje e të njëjtës shtëpi, të shkatërruar gjatë sulmit dhe rezistencës së 5 dhe 6 marsit (e punuar nga Donikë Shahini).³⁸ Këto ilustrime nga Prekazi bëhen brenda intervistës së plotë të Hamëz Jasharit, që po vinte tashmë para publikut dhe të cilën heroi e kishte dhënë enkas për revistën "Kombi". Kjo intervistë e rëndësishme së madhe, e bërë nga autorja e këtij punimi, mban titullin: "Jam i gatshëm në çdo moment ta pres vdekjen".³⁹

Një fotografi për të gjitha kohët

Në periudhën për të cilën po shkruajmë nuk ishin të paktë gazetarë të huaj të cilët improvizonin intervista me pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në fakt, i mjaftonte një gazetar të huaj që ta takonte një fshatar me një pushkë të vjetër në krahë dhe ta merrte një opinion nga ai lidhur me luftën, UÇK-në, Adem Jasharin, politikën serbe në Kosovë etj. Shtypi ndërkombëtar kishte përplot shkrime të këtilla, por asnjë pjesëtar të UÇK-së të identifikuar me emër dhe me mbiemër. Kështu, mbase këmbëngulja e redaksisë së "Kombit", apo edhe fati e deshi që, pas intervistës historike me Hamëz Jasharin, pikërisht në faqet e "Kombit" të botohet një intervistë superekskluzive me



NË REVISTËN KOMBË (2)

Afrim Mustafa në zonën e Nerodimes etj. Me një fjalë, në tërë Kosovën. Por asnjëherë nuk e humbën ekuilibrin, pavarësisht nga ajo që panë apo edhe që regjistruan me syrin e kamerës. Pavarësisht nga barbaritë e armiqve të Kosovës që po ndeshnin në çdo pëllëmbë të Kosovës ku qëndruan, qoftë në mesin e luftëtarëve, apo edhe në atë të refugjatëve që dergjeshin maleve të pamëshirshme të Kosovës. Me një fjalë, asnjëherë nuk e humbën dinjitetin. Madje, siç u theksua më lart në këtë punim, ata, bashkë me pjesën tjetër të redaksisë, me opinionistët e shquar Milazim Krasniqi, Teki Dervishi, Ekrem Kryeziu, Nexhmedin Spahiu, Melazim Koci, Bajram Kelmendi etj., të thuash krijuan një

pasojë.⁴⁶ Kontributet e këtyre gazetarëve, qoftë në gazetarinë e shkruar apo edhe në fotogazetari, janë të një vlere të jashtëzakonshme jo vetëm për historinë e gazetarisë sonë. Ato janë dëshmi të një të vërtete të padiskutueshme. Të një të vërtete të cilën, më mirë se cilitdo gazetar tjetër i Kosovës, e ngrinë dhe e përjetësuan pikërisht këta reporterë dhe këta fotoreporterë të revistës e cila u financua nga një familje e vetme dhe u mbështet nga një staf burrash dhe grash të guximshëm dhe të dijshtëm në shtjellimin e mjeshhtërisë së gazetarisë. Për këto arsye më 21 mars 1999 drejtori dhe botuesi i kësaj reviste, Haki Mulliqi, si dhe kryeredaktori i saj, Haqif Mulliqi, u dënuan në vlerë prej

kësaj reviste, Haqif Mulliqi, i cili, në një intervistë dhënë "Radio 21", gazetarit Florin Kelmendi, do të shprehet: "Këtë revistë e kemi nxjerrë jo t'i përfillim dhe respektojmë ligjet e Serbisë, por t'i refuzojmë, kontestojmë dhe përmbysim ato. Ndaj, e them botërisht se ne, kurrës nuk do t'i paguajmë asnjë metelik të vetëm Serbisë për gazetën tonë e as për punën e gazetarëve tanë".⁴⁸ Revista "Kombi" është një prej medimeve të pakta që lindi, u zhvillua dhe u rrit me luftën e Kosovës. Shkrimet dhe fotografitë që zunë vend në këtë revistë janë pjesë e dokumentimit të asaj që ka ndodhur në këtë vend të luftës dhe përpjekjes për mbijetesë të popullit të Kosovës dhe të ushtrisë së saj - UÇK-së. Ndaj mendojmë se kushdo që do t'i qaset më seriozisht sot apo nesër studimit dhe vlerësimit të luftës së Kosovës, vështirë se do t'ia dalë që ta anashkalojë revistën e "Kombit" dhe të mos i shprehë mirënjohje stafit të saj të vyer, të guximshëm dhe të shkëlqyer. Por, asnjëherë nuk duhet harruar se e tëra kjo u bë në kushte dhe rrethanat të papandehur për sigurinë e një gazetari apo një fotoreporter. Me mjete të cilat është vështirë sot t'i imagjinojmë se në çfarë niveli teknologjik ishin. Por, megjithatë, kjo revistë ndodhi bashkë me stafin e saj i cili punën e vet tërësisht ia kishte përkushtuar çështjes së atdheut.

5. Konkluzion

E ardhmja e fotografisë, edhe në gazetarinë tonë, sikundër gjithandaj në gazetarinë botërore, ka shënuar dhe do ta shënojë edhe në të ardhmen një pjesë të madhe të përditshmërisë sonë. Por, sido që të jetë, mendojmë dhe besojmë se detyra e një fotoreporterit gazetaresk, një fotografi të një gazete, apo edhe



Gazetaret e revistës "Kombi". Fotografi e realizuar nga Hamëz Jashari

politikë redaksionale joviolente, por gjithsesi përcëlluese për "të vërtetat" e armiqve të Kosovës. Ata nuk e zbukuruan të vërtetën, por e evidentuan të atillë çfarë ishte, e vrazhdë, e dhembshme apo edhe e lavdishme. Qëllimi parësor ishte që t'i ruanin njerëzit e gazetës, por edhe personazhet e artikujve që të mos identifikoheshin. Po u lëshuam një shikim më të hollësishtëm të tërë numrave që stafi i "Kombit" i realizoi për një vjet e gjysmë luftë, atëherë do ta shohim se asnjëherë nuk u dekonspiruan, e asnjë detaj të vetëm vendet ku gazetarët e kësaj reviste zhvilluan biseda me personazhe aq të rëndësishme për luftën dhe të ardhmen e Kosovës. Asnjëherë nuk u bë asnjëlloj montimi, hiç rastin e korrektimit të një fotoje të gazetarit Afrim Mustafa i cili, gjatë kohës kur, diku në malet e Kaçanikut po e zhvillonte bisedën me komandant "Bardhin", tashmë dëshmorin e kombit, meqë në kokë e kishte kapelën me emblemë, ajo iu mbulua që të mos kishte ndonjë

400 mijë markash gjermane nga një gjykatë serbe e Prishtinës, sipas padisë së ministrit të atëhershëm të Informatave të Republikës së Serbisë, ndërsa presidentit të saj të sotëm, Aleksandar Vuçiq.⁴⁷ Natyrisht se përgjegjësit e "Kombit" u shprehen publikisht se nuk e kanë ndërmend t'i paguanin ato mjete të dënimit, ndërsa do të mbahet mend deklarata e kryeredaktorit të



një gazetari me aparat fotografik në dorë, pavarësisht prej përvojës së tij në fotografibërje, asnjëherë nuk do të matet me cilësinë e kamerës fotografike, as me milionat e pikave që do t'i përmbajë apo nuk do t'i përmbajë një fotografi, por me faktin që do të ndërlidhet me profesionalizmin e një fotoreporterit apo gazetari - pra, të qenit në vendin e duhur dhe në kohën e duhur. Në fakt, në filozofinë e gazetarisë kjo është detyra e vetme e një fotoreporterit. Ndërsa, për të gjithë ata që nuk e dinë, të qenit reporter lufte, apo edhe fotoreporter lufte është më shumë sesa një guxim. Është edhe më shumë se mision. Është, thjesht, dëshmi e të qenit gazetar dhe fotoreporter profesionist dhe me karizëm. Besojmë se edhe ky punim e dëshmon qartë se të këtyllë ishin gazetarët dhe fotoreporterët e revistës e cila me tërë qenien iu përkushtua të vërtetës së luftës së Kosovës, pra revistës së përdyjavshme "Kombi". Po e përfundojmë këtë shkrim me një mendim të eurodeputetit Jaak Vandemeulebrck i cili, në maj të vitit 1998, duke parë përmbajtjen dhe angazhimin e stafit redaktues dhe të reporterëve të kësaj gazete, shprehet: "Pra, siç edhe mund të shihet dhe nga fjalët e

eurodeputetit, revista 'Kombi' me fotografitë e veta lufton në dy fronte: në atë të drejtës si dhe në atë të dokumentimit të saj".⁴⁹

25 *Kombi*, nr. 6, datë 13 mars 1998, f. 14
 26 *Kombi*, nr. 6, datë 13 mars 1998, f. 15
 27 *Kombi*, nr. 6, datë 13 mars 1998, f. 14 dhe 15
 28 *Kombi*, nr. 6, datë 13 mars 1998, f. 28
 29 Po aty f. 28
 30 *Kombi*, nr. 6, datë 13 mars 1998, f. 29
 31 *Kombi*, nr. 7, datë 31 mars 1998, f. 5, 6 dhe 7
 32 Po aty f. 5, 6 dhe 7
 33 Po aty f. 5, 6 dhe 7
 34 *Kombi*, nr. 7, datë 31 mars 1998, f. 7
 35 Haqif Mulliqi, deklaratë
 36 Sokol Dobruna, veprimtar dhe ish i burgosur politik, më pas pjesëtar i UÇK-së
 37 *Kombi*, nr. 7, datë 31 mars 1998, f. 7
 38 *Kombi*, nr. 7, datë 31 mars 1998, f. 9, 10 dhe 11
 39 *Kombi*, nr. 7, datë 31 mars 1998, f. 12, 13
 40 *Kombi*, nr. 9, datë 30.04. 1998
 41 Shih faqet 3, 6, 10, 11 të *Kombit*, nr. 9
 42 Artikulli *Kjo që po ndodh në Kosovë praktikisht është luftë*, *Kombi*, nr. 10, datë 16 maj 1998, f. 10, 11, 12
 43 *Kombi*, nr. 10, datë 16.05.1998
 44 Haki Mulliqi, drejtor i *Kombit*, deklaratë
 45 *Kombi*, nr. 19, datë 21 mars 1999, f. 18
 46 <http://www.ex-yupress.com/yualbpress.html>
 47 *Radio 21*, emisioni i lajmeve, datë 21 mars 1999
 48 *Kombi*, nr. 11, datë 15.06.1998, f. 18

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Elshani, besnik i Drenicës

Futbollisti Qemail Elshani, i njohur si "Qema", ka hedhur poshtë të gjitha spekulimet se ai mund të jetë lojtar i Vushtrisë apo Besës së Pejës, pasi ka vendosur t'i mbetet besnik skuadrës së Drenicës. "Ka pasur disa oferta nga Besa dhe Vushtrria, por nuk kam biseduar për shkak se kam kontratë me Drenicën dhe dua ta respektoj", ka thënë Elshani



drejtohet nga Tahir Lushtaku edhe në të ardhmen. "Ne e kishim vazhduar kontratën më herët me Drenicën, por prezantimi ende nuk ka ndodhur. Nëse ka ndonjë paqartësi nga ana e

klubit, sigurisht se do të më njoftojnë mua e unë mediet", ka deklaruar Elshani.

Futbollisti nga Drenasi ka luajtur me shumë sukses për Feronikelin, Prishtinën dhe

Besën, kurse një kohë të shkurtër ka qenë pjesë edhe e Partizanit në Shqipëri.

Ferizaj transferon 9 lojtarë, 6 largohen

Skuadra e Ferizajt ka bërë nëntë transferime në këtë afat kalimtar. Ndërsa nga kjo skuadër janë larguar gjashtë lojtarë. Nga transferimet e Ferizajt vërehet se lojtarët e transferuar janë me përvojë si Fisnik Papuqi, Taulant Dajaku, Donat Kaçi, Dardan Jashari, Ergon Hyseni, Filonit Shaqiri, Zgjim Mustafa, Përparim Livoreka dhe Fatih Karahoda. Në mesin e lojtarëve të larguar bëjnë pjesë Qëndrim Dautaj, i cili vendosi që karrierën të vazhdojë në Gjilan. Lojtarët e tjerë të larguar janë Drilon Islamaj, Armend Aliu, Viktor Kuka, Genc Hamiti dhe Durim Gashi.

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 KORRIK - Mesfushori i njohur në futbollin e Kosovës, Qemail Elshani, do të djersijë fanellën kuqezi të Drenicës edhe në edicionin 2019/2020. Mesfushori në fjalë ka thënë të dielën për "Epokën e re" se ofertat nuk i kanë munguar, por është i vendosur për ta respektuar kontratën me skuadrën nga Skenderaj. "Kam pasur disa oferta nga Besa dhe Vushtrria,

por nuk kam biseduar për shkak se kam kontratë me Drenicën dhe dua ta respektoj. Kontrata me obligon të qëndroj te KF Drenica deri në qershor të vitit 2020. Kam kaluar mirë me klubin dhe tifozët që kanë një simpati ndaj meje dhe gëzoj respekt të madh në këtë klub, prandaj gjithmonë e kam dhënë maksimumin për Drenicën", ka thënë Elshani, i cili në këtë mënyrë ka mbyllur të gjitha thashethemet që kanë qarkulluar në opinion dhe do të jetë pjesë e klubit që

Besa arrin marrëveshje me trajnerin Rama dhe futbollistin Gashi

PEJË, 21 KORRIK - Skuadra e Besës nga Peja duket se e ka seriozisht mendimin për t'u rikthyer sërish në Superligën e Kosovës në futboll. Kjo skuadër ditë më parë e ka transferuar nga Dukagjini i Klinës mesfushorin Dukagjin Gashi, kurse tash ka arritur marrëveshje me trajnerin Miftar Rama. Gazeta ka mësuar se marrëveshja mes trajnerit Rama dhe drejtuesve të Besës është arritur, kurse prezantimi do të bëhet gjatë javës. Rama e ka drejtuar edhe në të kaluarën skuadrën e Besës, derisa për një kohë ka qenë edhe trajner i Beharit në Ligën e Dytë. Besën edicionin e kaluar e ka drejtuar Fisnik Gashi, ndërsa një tjetër futbollist që do të jetë pjesë e skuadrës pejane është mes-



fushori Fatlum Gashi. Skuadra pejane edhe në edicionin e ri do të bëjë gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll.

Fresk Sylhasi, Forta Morina dhe Vesa Gjinajn humbasin në 'Baku 2019'

PRISHTINË, 21 KORRIK - Tenisti Fresk Sylhasi nuk arriti të kalojë garuesin me shumë përvojë të Zvicrës, Mrika Brunolds, nga i cili u mund 2:0 në sete (6:1, 6:1), në rrethin e parë të Festivalit Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019". Garuesi i Kosovës dha maksimumin ndaj kundërshtarit me shumë cilësi. Ai në ditët e ardhshme do të garojë edhe në çifte me Melos Nallbanin. Melosi përballet sot (e hënë) me Alin Fatu të Rumanisë. Ndërsa tenistja Forta Morina nuk arriti ta kalojë bartësen e grupit, Chelsea Fontenel të Zvicrës. Shorti jo i mirë për Fortën bëri që ajo të pësojë humbje 2:0 në sete (6:0, 6:0) në raundin e parë të Festivalit Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019". Ajo do të garojë nesër edhe në çifte me Vesa Gjinajn.



Tenistja me të ardhme të ndritur, Vesa Gjinaj, nuk arriti ta kalojë raundin e parë në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj

"Baku 2019", pasi u mund nga Melisa Senli (Turqi), 2:0 në sete (6:1, 6:1). Vesa do të garojë edhe në çifte me Forta Morinën.

Selmani diplomon me sukses në FIBA FECC

PRISHTINË, 21 KORRIK - Trajneri i njohur Ilir Selmani me sukses ka përfunduar shkollimin e FECC, që është në kuadër të shtëpisë botërore të basketbollit FIBA. Kështu, pas Dritëro Sefajës, Edon Godenit dhe Petrit Zeqirit, edhe Ilir Selmani e përfundoi shkollimin në FIBA për trajnerë, në programin prestigjioz FECC, që është i njohur në mbarë

botën dhe është shumë i rëndësishëm për trajnerët, derisa Federata e Basketbollit e Kosovës po investon në trajnerët e rinj që premtojnë për të ardhmen. "Pas tre vjetëve punë, përkushtim, sakrificë në programin (shkollimin) më të avancuar për trajnerë të basketbollit (FIBA-FECC), me sukses i përfundova provimet finale para

mësuesve (trajnerëve) më të mirë evropianë siç janë: Svetislav Peshiq, Nenad Truniq, Pablo Laso, Arik Shivek, Altay, Igor Kokoshkov dhe udhëheqësit të këtij programi Michael Shwarc. Faleminderit Federatës së Basketbollit të Kosovës për mundësinë e dhënë të jem pjesë e këtij programi", ka thënë Selmani.



Griezmann: Mezi po pres që Messi të rikthehet nga pushimi

BARCELONË, 21 KORRIK - Antoine Griezmann nga sezoni i ri do të luajë në një skuadër me Leo Messin. Të dy yjet kanë një profil të ngjashëm me depërtimet që nisin në krah e më pas spostohen në qendër. Ky fakt mund të shndërrohet në një problem për të dy yjet pasi do t'i zinin hapësirat e njëri-

tjetrit. Francezi mezi pret që Messi të kthehet nga pushimet për t'iu bashkuar ekipit. Ai është kurioz të shohë se si argentinasi sillet në jetën e përditshme dhe në stërvitje. Dëshiron të mësojë sa më shumë gjëra prej tij. "Do të jetë e mahnitshme të luaj bashkë me të. Mezi pres të shoh se si është ai në jetën e përditshme,

çfarë i pëlqen në stërvitje. Dua ta shoh atë që bën në stërvitje dhe të provoj ta përsëris ose ta bëj atë në mënyrën time. Dua ta njoh atë jashtë fushës. Mezi pres që ai të vijë. Nuk jam person i vështirë. Më pëlqen të jem i rrethuar nga njerëz. Jam i sigurt se çdo gjë do të jetë shumë mirë", ka thënë Griezmanni.



U19-shet e mbyllën Evropianin me humbje



PRISHTINË, 21 KORRIK - Përfaqësuesja U19 e Kosovës në hendboll (femrat) të dielën ka luajtur ndeshjen e fundit në Kampionatin Evropian, Divizioni B, që u mbajt në Klaipeda të Lituanisë. Kosova luajti për vendin e shtatë dhe u mposht nga Gjeorgjia me rezultat 29:28. Edhe një herë vashat nga Kosova lëshuan fitoren nga dora. Pas fillimit më të mirë të gjeorgjianeve, Kosova U19 krijoi epërsi prej dytri golash që e mbajti në pjesën e parë, e cila përfundoi 11:9 për Kosovën. Epërsia u rrit edhe më shumë në pjesën e dytë. Kështu

në minutën e 40 rezultati ishte 18:12 për Kosovën e më pas edhe 19:13. Në minutën e 54-t rezultati ishte 27:23 për Kosovën, por më pas ekipi u ndal. Në minutën e 58 rezultati u barazua në 27:27 e më pas edhe 28:28. Te Kosova nuk funksiononte asgjë as në mbrojtje e as në sulm dhe gjeorgjianet shënuan penallti në sekondat e fundit për ta fituar ndeshjen me rezultat 29:28. Pos me Çekinë që ishte superiore, vashat e Kosovës ishin rivale të barabarta në të gjitha ndeshjet e tjera me Turqinë, Ishujt Faroe dhe Maqedoninë Veriore. Të gjitha

Gjeorgjia - Kosova
29:28 (9:11)

Kosova: L. Gashi, E. Mulaj 3, Zymeri 1, M. Mulaj 1, Radoniqi, G. Gashi, R. Rexhepi 4, Kastrati 14, Matarova 1, Uka, Kelmendi 4, Halitaj, Rexhaj.

këto ndeshje u humbën në mungesë të fatit, koncentrimin në momentet e fundit dhe mospërvijës së shumicës së lojtareve. Ky evropian, megjithatë, do të shërbejë për të fituar përvojë dhe për të parë se çka kërkohet për sukses në nivel më të lartë.

Marko: Vetteli duhet të largohet nga Ferrari që të fitojë

BERLIN, 21 KORRIK - Për t'u rikthyer në nivelet e dikurshme, atëherë kur duelonte dhe fitonte titullin kampion bote në Formula 1, piloti gjerman Sebastian Vettel duhet të largohet nga Ferrari. I këtij mendimi është Helmut Marko, drejtuesi i Red Bullit, që e njeh mirë katër herë kampionin e botës, pasi kanë punuar së bashku te makina austriake. Sipas Marko, Sebastian Vettel nuk ka të njëjtën forcë si Michael Schumacher e Fernando Alonso. Ndaj, për të triumfuar ai ka nevojë për mbështetjen pa kushte të skuadrës. Sipas Marko, këtë gjë piloti gjerman nuk e ka, ndaj po dështon me makinën italiane. "Vetteli është një person shumë inteligjent, i ndjeshëm dhe i dashur. Por ndryshe nga pilotët e tjerë të mëdhenj që kanë pilotuar



një Ferrari, ai nuk arrin ta japë maksimumin nëse nuk e ka mbështetjen e skuadrës", ka thënë Marko. "Këtë gjë ai e kishte te Red Bulli, ndërsa te Ferrari nuk e ka këtë mbështetje. Gabimet që ai

bën në pistë vijnë vetëm si pasojë e mungesës së besimit, kur nuk je i sigurt në vetvete. Për mua, ai duhet të largohet nga Ferrari edhe pse për 2020-n nuk ka opsione konkrete", ka shtuar Marko.

SHKURT

Hysaj ndryshon mendje, qëndron te Napoli

Ndryshojnë të gjitha planet për Elseid Hysajn, mbrojtësin e Kombëtares shqiptare. Prej shumë javësh flitet për një largim të shqiptarit nga Napoli, por tashmë Hysaj kërkon të qëndrojë te klubi partenopei. Siç raporton "Corriere Dello Sport", ai është duke vlerësuar mundësinë e qëndrimit te skuadra e drejtuar nga Carlo Ancelotti. Edhe pse konkurrenca është e madhe në krahun e Hysajt, ai kërkon që të përballet me këtë situatë dhe ta bindë trajnerin italian. Kjo media raporton se për shqiptarin, Roma dhe Tottenhami janë të interesuara.

Zidane: Bale do të largohet nga Reali

Real Madridi pësoi humbje në ndeshjen miqësore ndaj Bayern Munchen (3-1), kurse Gareth Bale nuk u inkuadrua fare në lojë. Pas ndeshjes trajneri Zinedine Zidane ka konfirmuar se ylli i Uellsit do të largohet nga Real Madridi. "Bale nuk luajti sepse ai është shumë pranë largimit. Shpresoj se ai do të largohet së shpejti, pasi do të ishte gjëja më e mirë për të gjithë. Jemi duke punuar për transferimin e tij në një klub të ri. Nuk kam asgjë kundër tij, ama vjen koha kur gjërat duhet të bëhen sepse duhet të bëhen patjetër. Më duhet të marr vendime dhe të bëj ndryshime", ka thënë Zidane.

Silva përfundon në Monaco

Sulmuesi Andre Silva do të jetë lojtar i ri i skuadrës së Monacos. Marrëveshja mes dy klubeve është arritur derisa ish-sulmuesi i Portos i ka kushtuar skuadrës franceze 25 milionë euro, plus bonuset. Milani kishte paguar 38 milionë euro për sulmuesin portugez, i cili dështoi të dëshmohej në skuadrën kuqezi. Ai ishte huazuar edhe në Sevilla ku pati një start shumë të mirë, derisa tash do të luajë në Ligën 1.

Pjaniqi: Nuk kam ndërmend të largohem nga Juve

Miralem Pjaniqi po bëhet gati ta nisë sezonin e tij të katërt me Juventusin, por këtë herë nën drejtimin e Maurizio Sarrit. Mesfushori boshnjak foli me superlativa për trajnerin e ri dhe pranoi se i pëlqen roli të cilin Sarri i ka besuar. "Në futbollin e Sarrit, roli im është shumë i rëndësishëm dhe jam shumë i kënaqur për këtë. Mezi po pres të luajmë dhe të për-mirësohemi", ka thënë mesfushori boshnjak. "Më vjen të qesh kur lexoj se jam në merkato dhe se jam pranë largimit. E njëjta gjë ndodhi edhe vitin e kaluar, kur flitej për raporte jo të mira mes meje dhe Allegrit, ndonëse gjithçka ishte e përkryer. Jam shumë i lumtur te Juventus dhe nuk kam ndërmend të largohem", ka shtuar Pjaniqi.

Van Dijk: Ka ardhur koha që një mbrojtës ta fitojë 'Topin e Artë'

Diskutimet për "Topin e Artë" akoma nuk e kanë arritur kulmin, me trofeun që do të jepet në fund të vitit kalendarik. Virgil van Dijk dhe Leo Messi janë dy kandidatët kryesorë për ta fituar çmimin më prestigjioz në nivelin personal. Mbrojtësit holandez ka filluar t'i pëlqejë ideja se mund të fitojë "Topin e Artë". Mbrojtësi deklaroi se është i vetëdijshëm që ka bërë një sezon të madh dhe mendon se ka ardhur koha ta fitojë një mbrojtës atë çmim. "Është nder që njerëzit flasin për mua në garën për 'Topin e Artë', por unë nuk kam asgjë në dorë. Nuk e mohoj se kam pasur një sezon të mirë atë të kaluarin, por e vetmja gjë që mund të bëj tani është fokusi në sezonin e ri. E kuptoj faktin se sulmuesit apo numrat '10' fitojnë këto çmime sepse janë më të bukur për t'u parë. Megjithatë, mendoj se ka ardhur koha ta ndryshoj atë", u shpreh 28-vjeçari.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:**

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>
Titulli i punës:	Anketues/ Intervistues, Mbikëqyrës dhe Përfshirës (procesues) i të dhënave për Anketat në Ndërmarrje (Azhurnimi i RSB, Shfrytëzimi i TI nga ana e Ndërmarrjeve dhe Statistikat e Investimeve).
Numri i referencës:	ASK-DSE-001
Tarifa e shërbimit:	I negociuar
Raporton te:	Te njësia e statistikave ekonomike në ASK
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Tre (3) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK - 42

Detyrat dhe përgjegjësitë për Anketues:

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative (Të dhënat bazike të anketave) dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për Anketat në Ndërmarrje.
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për Anketat në Ndërmarrje
- Të bëjnë identifikimin e të gjitha bizneseve në bazë të mostrës duke bërë anketimin e të gjitha ndërmarrjeve.
- Të respektojnë udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që duhet t'i parashtrajnë personit përgjegjës në njësi raportuese dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën shqipe.
- Të bëjnë raportimin ditor tek mbikëqyrësi.
- Të përfundojnë Anketat brenda afatit.
- Të mbajnë të gjitha informatat e pranuar nga bizneset si sekret zyrtar.

Përgatitja shkollor/përvoja:

- Të kenë të kryer së paku shkollën e mesme.
- Të jenë student të ndonjë nga fakultetet.
- Të kenë përvojë në aplikimin e teknologjisë informative (laptopëve/tabletave)
- Përparësi kane kandidatët të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit.
- Përparësi kanë personat që kanë marrë pjesë së paku në një anketë.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunimi;
- Përvoja e mëparshme në anketat e ngjashme,
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi dhe njohuri në shfrytëzimin dhe përdorimin e Regjistrave;
- Aftësi kompjuterike, word, excel, internet etj.;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj me orar punë më të gjatë, përfshirë ditët e fundjavës.

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mbikëqyrës:

- Të marrin pjesë në trajnim dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative (Të dhënat bazike të anketave) dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketat.
- Të mbikëqyrin mbarëvajtjen dhe realizimin e Anketave në terren.
- Të bëjnë identifikimin e të gjitha problemeve dhe të bashkëpunojnë me Anketuesit dhe zyrtarët në ASK.
- Të respektojnë udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që duhet t'i parashtrajnë personit përgjegjës në njësi raportuese dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Përdorimi i adresave dhe listave për bizneset nga Mostra;
- Të njoftojnë zyrtarin për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;
- Të bëjnë raportimin në baza dyditore tek zyrtari.
- Të kujdeset që Anketat të përfundojnë brenda afatit.
- Të mbajnë të gjitha informatat e pranuar nga bizneset si sekret zyrtar.

Përgatitja shkollor /përvoja për mbikëqyrës për Anketat në Ndërmarrje

- Aplikantët që konkurrojnë për këtë vend të punës duhet të kenë të kryer ndonjë nga fakultetet, kandidatët me përgatitje më të lartë shkollorë kanë përparësi;
- Përvoja e mëparshme në mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së Anketës në terren, kontrollimin e pyetësorëve të anketave të ngjashme, si dhe të jenë të gatshëm të ju ndihmojnë anketuesve në teren kur ata kanë vështirësi ose kanë nevojë;
- Të kenë aftësi të mira organizative dhe të jenë të gatshëm të punojnë ndonjëherë me orar të zgjatur ditor përfshirë vikendet;
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe te punës ekipore.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi dhe njohuri në shfrytëzimin dhe përdorimin e Regjistrave;
- Aftësi kompjuterike, word, excel, internet etj.;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orar punë më të gjatë, përfshirë ditët e fundjavës.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së.

Numri i anketuesve	34 (tridhjetë e katër)
Përfshirës i të dhënave	4 (katër)
Numri i mbikëqyrësve	4 (katër)

Regjioni	Numri i anketuesve për regjion	Përfshirës i të dhënave	Mbikëqyrës
1 Gjakova	3	4	4
2 Gjilani	4		
3 Mitrovica	3		
4 Peja	4		
5 Prizreni	6		
6 Prishtina	9		
7 Ferizaj	5		
Gjithsej	34	4	4

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr, "Zene Salihu" nr.4, 10000 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: CV¹, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, tema e diplomës apo vërtetimi nga viti i fundit i nivelit të shkollimit (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen testit me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149, 200 31 133 apo 200 31 136 prej orës 08:00 -16:00.

¹ Përfshi: Nr. telefonit si dhe një adresë elektronike



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

Naziv institucije:	Agencija za Statistiku Kosova
Naziv pozicije:	Anketar/ Ispitivač, Supervisor i Unosač podataka za Poslovne Ankete (Ažuriranje SPR-a, korišćenje IT od preduzeća i statistika investicaja)
Referentni broj:	ASK-OES-001
Tarifa usluga:	Po dogovoru
Izveštava:	Jedinici Ekonomskih Statistika u ASK
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge–(SPU)
Trajanje ugovora:	Tri (3) meseca
Radno vreme:	Puno
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK- 42

Zadaci i odgovornosti:

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima – (osnovnih podataka anketa) i da bude spreman/na da ih primenjuje na terenu na osnovu uputstva za Poslovne Ankete.
- Prikuplja podatke za Poslovne Ankete;
- Vršiti identifikaciju svih poslovanja na osnovu uzorka anketiranjem svih preduzeća;
- Poštuje uputstva upitnika za pitanja koja treba postavljati odgovornom ispitaniku i prati sve procedure i objašnjenja navedena u uputstvima;
- Obavesti supervizora o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Intervjuisanje se sprovodi na Albanskom jeziku.
- Dnevno izveštava svom supervizoru;
- Da završi Ankete u propisanom roku;
- Sve dobijene podatke od poslovanja treba da čuva kao službenu tajnu;

Školska sprema/ iskustvo:

- Da ima najmanje završenu srednju školu.
- Da bude student bilo kog fakulteta;
- Iskustvo u primeni informacione tehnologije (laptopa/tablet računara)
- Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja;
- Prednost imaju osobe koje su učestvovala u barem jednoj anketi

Kompetencije i veštine:

- Dobre veštine komuniciranja i saradnje;
- Prethodno iskustvo u sličnim anketama;
- Spreman/na za timski rad;
- Sposobnost i znanja u korišćenju i upotrebu Registara;
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd
- Da ima dobre organizacione veštine i spreman/na da ponekad radi prekovremeno, uključujući vikende;

Zadaci i odgovornosti Supervizora:

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima – (osnovnih podataka anketa) i da bude spreman/na da ih primenjuje na terenu na osnovu uputstva za Poslovne Ankete.
- Prati napredak i sprovođenje Anketa na terenu;
- Identifikuje sve probleme i saraduje sa anketarima i zvaničnicima u ASK-u;

- Poštuje uputstva upitnika o pitanjima koje treba postavljati odgovornom ispitaniku u izveštajnoj jedinici i prati sve procedure i objašnjenja navedena u uputstvima;
- Koristi adrese i liste poslovanja iz Uzorka;
- Obavesti službenika o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Izveštava službenika na dvodnevnoj osnovi;
- Pobrine da Ankete budu završene u propisanom roku;
- Sve dobijene podatke od poslovanja čuva kao službenu tajnu.

Školska sprema/iskustvo supervizora za Poslovne Ankete

- Kandidati koji se prijavljuju za ovaj posao moraju imati završen neki fakultet, kandidati sa najvišim nivoom školske sprema imaju prednost;

- Prethodno iskustvo u praćenju napretka ankete na terenu, kontroli upitnika sličnih anketa i spreman/na da pomaže anketare na terenu kada su u poteškoćama ili kada im je to potrebno;

- Dobre organizacione veštine i spreman/na da ponekad radi prekovremeno, uključujući vikende;

- Dobre komunikacione veštine i sposobnost timskog rada.

Kompetencije i veštine:

- Dobre veštine komuniciranja i saradnje
- Spreman/na za timski rad;
- Sposobnost i znanja u korišćenju i upotrebu Registara
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd
- Dobre organizacione veštine i spreman/na da ponekad radi prekovremeno, uključujući vikende;

Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svi punoletni (stariji od 18.godina) Građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na veb- stranici ASK-a.

Broj anketara 34 (trideset četiri)
Unosača podataka 4 (četiri)
Broj supervizora 4 (četiri)

	Regioni	Broj anketara po regionu	Unosač podataka	Supervisor
1	Đakovica	3	4	4
2	Gnjilane	4		
3	Mitrovica	3		
4	Peć	4		
5	Prizren	6		
6	Priština	9		
7	Uroševac	5		
	Ukupno	34	4	4

Podnošenje prijave:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti u Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>.

Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zenel Salihu" br.4, 10000 Priština.

Uz prijavu potrebno je priložiti: CV¹, kopiju lične karte, dokumenat o prebivalištu, diplomski rad ili potvrdu iz poslednje godine nivoa školovanja studenta (svi dokumenti treba da budu kopije).

Prijave podnete nakon isteka roka neće biti prihvaćene. Nepotpune prijave će biti odbijena.

U slučaju velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Kandidati koji uđu u uži izbor biće intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038-200 31 149, 200 31 133 ili 200 31 136 od 08:00 – 16: 00 časova.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpallë:

REKRUTIM

Institucioni: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Agjencia e Metrologjisë së Kosovës

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Metrologjisë për Metale të Çmuara

Koeficienti / 7

Nr. i Referencës: MTI/23

Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 2

Vendi: Një (1) në Prishtinë, një (1) në Prizren

Data: 22/07/2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen detyra me të cilat sigurohet besueshmëria e shitjes së metaleve të çmueshme në Kosovë me cilësi të caktuar sipas ligjit dhe standardeve ndërkombëtare;
- Bën analizën kimike, kontrollimin dhe vulosjen e metaleve të çmuara;
- Bën ekspertizën e punimeve prej metaleve të çmuara, të parashtruara nga organet publike
- Bën kontrollimin e mjeteve matëse që përdoren për matjet fiziko-kimike;
- Mbikëqyr plotësimin e kushteve metrologjike në serviset dhe laboratorët e certifikuar;
- Përcjell të arriturat e reja në zhvillimin e metodave për shqyrtimin e përbërjes dhe pastërtisë së legurave të arit, argjendit dhe platinit;
- Merr pjesë në përpilimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve për metalet e çmuara

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare: FSHMN - drejtimi i Kimisë Inxhinierike, Fizikës, Fakulteti i Metalurgjisë, Fakulteti i Teknologjisë;
- Minimum 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e metaleve të çmuara ;
- Shkathësi në menaxhim, organizim dhe mirëmbajtjen e laboratorit të metaleve të çmuara;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathësi në komunikim dhe negocim;
- Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve në laborator;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e cmërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese. Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

05/08/2019

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga web faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit, në adresën www.mti-ks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më: **05/08/2019**. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

“Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova Zakon Br. 03/L-149, Uredba Br. 02/2010 o Procedurama za Zapošljavanje u Civilnoj Službi Republike Kosovo, Ministarstvo Trgovine i Industrije objavljuje:

REGRUTOVANJE

Institucija: Ministarstvo Trgovine i Industrije

Kosovska Agencija za Metrologiju

Naziv radnog mesta: Službenik za Metrologiju za Plemenite Metale

Koeficijent / 7

Referentni br: MTI/ 23

Broj zvaničnika koji će biti prihvaćeni: 2

Mesto: Jedan (1) u Prištini, jedan (1) u Prizrenu

Datum: 22/07/2019

Dužnosti i odgovornosti:

- Obavljaju dužnosti kojima se osigurava pouzdanost prodaje plemenitih metala na Kosovu sa kvalitetom u skladu sa zakonom i međunarodnim standardima;
- Vrše hemijsku analizu, proveru i pečat plemenitih metala;
- Obavljaju ekspertizu radova od plemenitih metala, koji su podneli javni organi;
- Obavljaju kontrolu mernih instrumenata koji se koriste za fizičko-hemijska merenja;
- Nadgledaju ispunjavanje metroloških uslova u sertifikovanim servisima i laboratorijama;
- Prate nova dostignuća u razvoju metoda za razmatranje sastava i čistoće legura zlata, srebra i platine;
- Učestvuju u izradi podzakonskih akata i propisa za plemenite metale.

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska Diploma: FMPN-Hemijsko Inženjerstvo, Fizički, Metalurški Fakultet, Tehnološki Fakultet;
- Minimum 2 godine radnog iskustva u struci;
- Znanje i iskustvo u oblasti plemenitih metala;
- Veštine u upravljanju, organizaciji i održavanju laboratorije za plemenite metale;
- Dobro poznavanje efikasnog nadzora nad stručnim radom obavljen od podređenih;
- Sposobnosti u komunikiranju i pregovaranju;
- Fleksibilan pristup organizovanju i nadgledanju rada, uključujući i rešavanje problema u laboratoriji;
- Kompjuterske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);

Uslovi učesća u regrutovanju:

Pravo apliciranja imaju svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu poslovnu sposobnost, imaju visoku školsku spremu i stručnu sposobnost za obavljanje obaveza.

Trajanje imenovanja:

Službenik karijere (trajni). Probni period: dvanaest (12) meseci.

Datum zatvaranja konkursa:

05/08/2019

Podnošenje zahteva

Obrasci za apliciranje preuzimaju se na recepciji MTI-a, ili se preuzimaju sa web stranice MTI-a, gde je objavljen konkurs, na adresi www.mti-ks.org i podnose se Diviziji za Ljudske Resurse, svakog radnog dana od 8:00 -16:00 časova do: **05/08/2019**.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na tel. 038-200 36-578.

“Civilna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu”.

“Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno predstavljanje u organima civilne službe centralne i lokalne javne uprave kao što je definisano u Članu 11, stav 3 Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo”

Nepotpune aplikacije i podnescene posle krajnjeg roka neće biti prihvaćene.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati izabrani na užem spisku će biti kontaktirani.

U bënë një muaj pa më të dashuri tonë,
Bashkëshortin, babain, vjehrrin e gjyshin shembullor



Skender Kallaba

(21.01.1943-24.06.2019)

Bashkëshort, baba, gjysh i dashur, u bënë një muaj të mungesës tënde dhe të jetës sonë pa Ty. Nuk ka fjalë, lot as vajë që e shuan mallin për ty, ishin këto ditë të rënda për ne. Por mërzia dhe krenaria që të patëm shkojnë paralel.

Vdekja të ndau nga jeta, por jo nga zemrat tona! Ishe dhe do të mbetesh i dashur për të gjithë ne, na krijove kushte për jetë dhe punë, vetëdije e ndërgjegje të lartë.

Sot të kujtojmë me mall dhe ngushëllojmë njëri - tjetrin se një ditë do të takohemi në amshim.

Të kujtojnë me shumë mall: bashkëshortja Sevdija me familje dhe e gjithë familja Kallaba nga Rogana e Kamenicës.

40 vjet pa babën e 28 vjet pa nënën, dy më të dashurit tanë

Foto: Eqrem Zenelaj (1977)

**Musli Ymer
Zenelaj****Hajrije Osman
Bytyqi-Zenelaj**

Prej që ikët nga kjo botë, ti babë Musli dhe ti nënë Hajrije, latë mes nesh dhembje, kujtime, dashuri, krenari dhe mirësi. Ato ndjenja njerëzore që i kultivuat në familje, i shpërndamë në gjithë vendin dhe gjithë botën.

40 vjetët e shkuarjes në amshim të babës Musli Ymer Zenelaj janë vite të mallit të pashuar të një prindi të kujdesshëm për familjen.

Po kaq mall të madh ndiejmë edhe sot për nënën Hajrije Osman Bytyqi-Zenelaj, në 28-vjetorin e ndarjes nga jeta të saj, e cila na begatoi me urtësi dhe mirësi.

I kujtojnë: Eqrem Musli Zenelaj me bashkëshorten Kada Zenelaj-Maloku dhe fëmijët: Njomza, Adelina, Hajrija, Edionisa, Enisi dhe Elvisi.